




Manual për Gjyqtarë

LIGJI PËR FALIMENTIMIN NË KOSOVË

IN COOPERATION
WITH:



 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO



Creating Markets, Creating Opportunities

VËMENDJE

Ky Manual është shkruar nga konsulentet e Korporatës Financiare Ndërkombetare (IFC) - anëtare e Grupit të Bankës Botërore, të cilët kanë bërë përpjekjet më të mira për kohën në dispozicion, për të siguruar shërbime të cilësisë së lartë dhe janë bazuar në informatat e siguruar nga një gamë e gjerë burimesh.

Opinionet dhe konkluzionet e përfshira në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e IFCsë, Grupit të Bankës Botërore, bordit të saj udhëheqës dhe vendeve që i përfaqësojnë. IFC nuk bën ndonjë përfaqësim dhe nuk jep ndonjë garanci sa i përket plotësisë apo saktësisë së informacioneve të përfshira në këtë Manual, apo sa i përket rezultateve të cilat do të arriheshin duke ndjekur rekomandimet e tij.

Këtë publikim e ka mbështetur Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO). Opinionet dhe konkluzionet e përfshira në këtë botim nuk do të i atribuohen dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e SECOsë.

Ky dokument ka një shpërndarje të kufizuar dhe mund të përdoret nga pranuesit vetëm për ushtrimin e detyrave zyrtare të tyre. Përmbajtja e tij nuk mund të shpalojë në forma të tjera pa autorizimin e IFCsë.

Manual për Gjyqtarë

LIGJI PËR FALIMENTIMIN NË KOSOVË

IN COOPERATION
WITH:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO



IFC

**International
Finance Corporation**
WORLD BANK GROUP

Creating Markets, Creating Opportunities

PËRMBAJTJA

- 9 | Lista e Shtojcave
- 10 | Parathënie
- 12 | Hyrje

KAPITULLI I: KUPTIMI I FALIMENTIMIT

- 13 | Rreth falimentimit në përgjithësi
- 14 | Leximi dhe Interpretimi i Ligjit të ri të Falimentimit në Kosovë
- 14 | Parimet e Përgjithshme të Ligjit të Ri për Falimentimin
- 15 | Përkufizimet
- 16 | Fushëveprimi i aplikimit
- 16 | Juridiksioni Gjyqësor dhe Mjetet Ligjore

KAPITULLI II: PJESËMARRËSIT KRYESOR DHE PALËT ME INTERES NË NJË PROCEDURË FALIMENTIMI

- 17 | A. Debitori
- 18 | B. Kreditorët dhe Komiteti i Kreditorëve
- 19 | C. Përfaqësuesi i Pasurive të Falimentimit
- 22 | D. Gjyqtari

KAPITULLI III. INICIMI I PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

- 23 | A. Palët e lejuara për të aplikuar për riorganizimin dhe likuidim
- 24 | B. Inicimi i procedurës
- 25 | C. Kundërshtimet dhe provat
- 25 | D. Vendimet dhe Ankesat

KAPITULLI IV. EFEKTET E INICIMIT TË PROCEDURËS SË RIORGANIZIMIT PO LIKUIDIMIT

- 27 | Hapja e Rastit
- 27 | Krijimi i Pasurisë Falimentuese
- 28 | Moratoriumi Automatik
- 29 | Financimi pas aplikimit të pasurisë falimentuese
- 29 | Kontratat dhe obligimet ende me detyrim të përmbushjes nga dy palët
- 30 | Braktisja e pasurive rënduese për pasurinë falimentuese

KAPITULLI V KËRKESAT, PROCEDURAT E KËRKESAVE NË RIORGANIZIM DHE LIKUIDIM

- 31 | A. Paraqitja e Kërkesës
- 32 | B. Kundërshtimi i kërkesës dhe verifikimi
- 33 | C. Efektet e verifikimit

KAPITULLI VI BLERJA E PASURIVE DHE SHMANGIA E BARTJES

- 34 | Bartjet preferenciale
- 35 | Bartjet jo komerciale dhe për qëllime mashtrimi
- 35 | Bartjet e paautorizuara pas paraqitjes së kërkesës për falimentim
- 35 | Kërkesat e siguruara të papërshtatshme
- 35 | Pasojat e anulimit të bartjes

KAPITULLI VII. RIORGANIZIMI

- 37 | A. Plani i Riorganizimit.
- 39 | B. Përmbajtja e planit të riorganizimit.
- 41 | C. Shumica e kërkuar dhe votimi
- 41 | D. Seanca dëgjimore për riorganizimin.
- 41 | E. Pasojat juridike të konfirmimit të planit
- 42 | F. Mjetet juridike në rast të dështimit të përmbushjes së Planit të Riorganizimit
- 42 | G. Mbyllja e Rastit të Riorganizimit

KAPITULLI VIII: PROCEDURA E LIKUIDIMIT

- 43 | A. Emërimi detyrues i një Administratori
- 43 | B. Kreditorët e Siguruar mbesin të Siguruar
- 44 | C. Shitja e Aseteve
- 44 | D. Përmbushja e Kërkesave.
- 45 | E. Shndërrimi i rastit të likuidimit në riorganizim
- 45 | F. Realizimi i shpërndarjeve – Parimi Pari Passu
- 46 | G. Përparësia e kërkesave dhe Shpërndarjeve

KAPITULLI IX: LIRIMI NGA BORXHET DHE MBYLLJA E PROCEDURËS SË LIKUIDIMIT

- 47 | A. Lirim i
- 48 | B. Mbyllja e rastit
- 48 | C. Dispozita specifike sa i përket llojeve të ndryshme të Organizatave Biznesore

KAPITULLI X: NVM-TË DHE PROCEDURAT E PËRSHPEJTUARA

- 50 | A. Kriteret për NVM-të
- 50 | B. Emërimi i Monitoruesit
- 50 | C. Ndryshimi i votimit tradicional të kreditorëve
- 51 | D. A Një qasje tjetër për të përcaktuar realizueshmërinë
- 51 | E. Heqja e Rregullit me Përparësi Absolute për NVM-të

52 | BIBLIOGRAFIA

Lista e Shtojcave

- Shtojca 1:** Vendimi për Refuzim të Kërkesës
- Shtojca 2:** Vendimi për Konsolidimin e Rasteve
- Shtojca 3:** Vendimi për të Pranuar Kërkesën, Hapjen e Rastit dhe Vendosjen e Moratoriumit
- Shtojca 4:** Njoftimi i Gjykatës për Regjistrin e Biznesit, Regjistrin e Pengut, Administratën Tatimore dhe Bankat Komerçiale për Hapjen
- Shtojca 5:** Vendimi për Emërimin e Administratorit
- Shtojca 6:** Vendimi për Shkarkimin e Administratorit dhe Emërimin e Administratorit të Ri

Parathënie

Për IFC- në

Korporata Financiare Ndërkombetare (IFC) - anëtare e Grupit të Bankës Botërore - është institucioni më i madh global i zhvillimit i përqendruar në sektorin privat në tregjet në zhvillim. Ne punojmë në më shumë se 100 vende, duke përdorur kapitalin, ekspertizën dhe ndikimin tonë për të krijuar tregje dhe mundësi në vendet në zhvillim. Në vitin fiskal 2020, kemi investuar 22 miliardë dollarë në kompani private dhe institucione financiare në vendet në zhvillim, duke shfrytëzuar fuqinë e sektorit privat për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët. Për më shumë informacion, vizitoni www.ifc.org

Programi i IFC-së për Zgjidhjen e Borxhit dhe Daljes së Biznesit

Programi rajonal i IFC-së për Zgjidhjen e Borxhit dhe Daljes së Biznesit synon të përmirësojë sistemet e falimentimit në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi) për një periudhë 4-vjeçare të zbatimit. IFC, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, kryen këtë iniciativë në partneritet me qeverinë e Zvicrës, të përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Ndikimi i pritshëm i zbatimit të Projektit është të zhvillojë një kornizë dhe praktikë fleksibile dhe efektive të falimentimit dhe para-falimentimit që do rezultojnë në ruajtjen e bizneseve të qëndrueshme sipas parimit të vijimësisë ose në një likuidim efikas duke kthyer kështu asetet e bizneseve të padisponueshme në përdorim produktiv. Në aspektin afatgjatë, gjithashtu pritet të zvogëlojë rrezikun e huadhënies dhe si pasojë ta bëjë kredinë më të arritshme.

Në Kosovë në veçanti, qëllimi është që të nxisë mekanizmin e falimentimit në praktikë, por gjithashtu të promovojë zgjidhjen e rasteve jashtë gjykatës dhe procedurë të përsheptuar të ristrukturimit, si në të gjithë rajonin. Kjo do të arrihet përmes asistencës teknike të synuar për:

- përmirësimin e legjislacionit primar dhe sekondar për regjimin e falimentimit dhe para-falimentimit;
- forcimin e kornizës institucionale për administratorët e falimentimit;
- të rrisë kapacitetin e akterëve kryesorë në procesin e falimentimit; dhe
- të ndërtojë mekanizma për të promovuar përdorimin e sistemit të falimentimit.

Për SECO-në

Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) është qendra kompetente e Konfederatës së Zvicrës për të gjitha çështjet që lidhen me politikën ekonomike, duke përfshirë zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin. SECO përpiqet të arrijë një rritje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe uljen e varfërisë në vendet partnere. Aktivitetet SECO-së synojnë të krijojnë më shumë vende pune, të rrisin tregtinë dhe konkurrencën, të mbështesin institucionet dhe shërbimet efektive dhe të nxisin zhvillim ekonomik të qëndrueshem dhe miqësor ndaj klimës. Për më shumë informacion, vizitoni www.seco-cooperation.admin.ch.

Ligji për Falimentimin në Kosovë është ligj relativisht i ri dhe me praktikë mjaft të limituar. Disa donatorë janë angazhuar gjatë viteve të fundit në procesin e reformimit të ligjit dhe të procedurave në Kosovë, dhe deri më tani, vetëm IFC dhe USAID kanë punuar drejtpërdrejtë me Ligjin për Falimentimin. Gjitha këto përpjekje kanë rezultuar në përmirësimin e renditjes së Kosovës në Raportin e Bankës Botërore të të Bërit Biznes, me një rritje domethënëse në renditje sa i përket indikatorit të zgjidhjes së insolvencës.

Sigurisht duhet të bëhet më shumë punë. Me ndihmën mjaft bujare të IFC-së dhe SECO-së, ne kemi arritur të zhvillojmë dy Manuale të cilat posaçërisht i dedikohen Ligjit për Falimentimin dhe zbatimin e tij; Manuali për Gjyqtarë dhe Manuali për Administratorët e Falimentimit. Të dy Manualët kanë për qëllim që të ndihmojnë Gjykatësit, Administratorët dhe praktikuesit e tjerë ligjorë në zbatimin e Ligjit të ri dhe të Procedurave të reja.

Ne presim me padurim që të punojmë ngushtë me gjithë akterët relevant për të përmirësuar tutje në të ardhmen këto manuale dhe praktikën e Falimentimit në Kosovë në përgjithësi.

Mahir Tutuli, gjykatës
Shef i Departamentit për Çështje Ekonomike
Gjykata e Apelit në Kosovë

Hyrje

Rëndësia e procedurave të falimentimit është theksuar fuqishëm në periudhën e fundit për shkak të ndryshimeve në trendet ekonomike të cilët parashikuan rritjen e volumit të dështimeve të kompanive. Kriza ekonomike e vitit 2008 ishte një mësim i mirë që vëmendje më të madhe duhet ti kushtohet mbylljes së bizneseve, përpos stimujve për ngritjen e bizneseve (start ups). Kriza e re ekonomike e cila ka gjasë të rezultojë pas bllokadës së shkaktuar si pasojë e virusit COVID-19 është një përkujtesë dhe një sistem i fortë i riorganizimit duhet ta ketë për firmat e qëndrueshme me probleme financiare dhe një sistem i fortë i likuidimit për të eliminuar në mënyrë të shpejtë firmat e paqëndrueshme. Më shumë se kurrë, sistemi i josolvensës duhet të shihet si një mjet i përdorshëm në duart e gjykatësve, praktikuesve, biznesmenëve dhe lojtarëve të tjerë kritikë në industrinë e ndryshme për të arritur ristrukturime dhe dalje efektive.

Ligji i parë në Kosovë sa i përket falimentimit për subjektet private ishte miratuar në muajin Prill 2003 dhe ishte dekretuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (SPSSP) si Rregullorja nr. 2003/7 e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) (tutje referuar si “**Ligji i Parë i Falimentimit**”). Ky Ligj u plotësua nga Ligji nr. 02/L-115 në vitin 2008, për të adresuar vetëm një çështje prioritare të Administratës Tatimore të Kosovës si një kreditor.

Në vitin 2014, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (“MTI”) filloi procesin e reformimit të Ligjit të Parë të Falimentimit, me mbështetjen e Programit për Përmbartim dhe Legjislacion Komercial në Kosovë (“CLE”) të Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim të Shteteve të Bashkuara (USAID). Në vitin 2015, Ligji i ri për Falimentimin u bë pjesë e programit legjislativ dhe më datë 7 Korrik 2016, Parlamenti i Kosovës miratoi Ligjin Nr. 05/L-082 për Falimentimin (“**Ligji i ri për Falimentimin**”).

Deri në vitin 2016, korniza rregullatore e falimentimit në Kosovë ishte e fragmentuar dhe e dobët. Gjykatat kishin filluar aplikimin e regjistrave për rastet e falimentimit mirëpo asnjë procedurë e josolvensës nuk po zhvillohej. Përgjatë kësaj periudhe kishte bërë një rast i cili administrohej bazuar në Ligjin e Parë të Falimentimit. Për shkak të mungesës së praktikës së përgjithshme të rasteve të falimentimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri, ishte e nevojshme që të hartohet një Manual për zbatimin më të lehtë të ligjit.

Kapitulli I:

Kuptimi i Falimentimit

Rreth falimentimit në përgjithësi

Në periudhat e rënieve ekonomike, kompanitë kanë më tepër të ngjarë të gjenden në kushte të vështira financiare. Në disa raste, ato nuk janë në gjendje që të përmbushin obligimet e tyre dhe nuk mund të paguajnë plotësisht borxhet e tyre. Shpeshherë, ato obligohen që të paraqesin kërkesë për falimentim apo të kërkojnë mbrojtjen e këtij sistemi. Falimentimi është një procedurë ligjore përmes së cilës debitorët të cilët nuk mund të shlyejnë borxhet e tyre të papaguara (apo ato të ardhshmet) mund të kërkojnë mbrojtje ligjore nga veprimet përmbartimore të kreditorëve, të përpiqen të kthejnë fatin e tyre prapa, dhe të gjejnë një zgjidhje të përbashkët efektive për paaftësinë e tyre paguese.

Falimentimi siguron përfitime të vlefshme për kreditorët si dhe debitorët.

Në momentin kur një debitor paraqet kërkesën e tij, kreditorëve i imponohet një qëndrim automatik (gjithashtu i njohur si moratoriumi mbi kërkesat), i cili pauzon çdo përpjekje për mbledhjen, çështjet gjyqësore, përmbartimin dhe veprime të ngjashme. Kreditorët apo një palë e interesuar mund të kërkojë nga gjykata që të heqë moratoriumin sipas disa kushteve të caktuara kufizuese, mirëpo standardi për të bërë kështu është i vështirë të arrihet. Raste të tilla të kufizuara përfshijnë dështimin e debitorit për të siguruar mbrojtje të vlerës për pasurinë apo barrën e kreditorit apo kur kreditori dëshmon që shumica e siguruar nga garancia e pagesës tejkalon vlerën e pronës e cila është subjekt i garancisë së pagesës.

Gjykata ka autoritet të gjerë për të kontrolluar gjitha çështjet që përfshijnë pasurinë e debitorit, sikurse:

- pauzimin e proceseve të tjera gjyqësore jashtë rastit të falimentimit nëse ato afektojnë pasurinë
- bashkimin e gjithë atyre hisedarëve në pronat e kompanisë në një vend në mënyrë që debitori të mund të merret në mënyrë më efektive me gjitha pretendimet kundër tij.

Qartazi, falimentimi i siguron debitorëve një fuqi të rëndësishme për të ri aranzhuar punët e tyre afariste. Çfarë shumica e njerëzve keqkuptojnë, megjithatë, është se kjo fuqi balancohet nga mbrojtjet e fuqishme të kreditorëve. Ligji për Falimentimin kërkon që debitorët të shpalosin informacione të rëndësishme sa i përket operacioneve të tyre dhe të imponojnë kontrollime të rrepta për veprimet e debitorëve. Për shembull, debitori duhet të dorëzojë informacione sa i përket gjitha pasurive dhe detyrimeve të tij, të qëndrojnë në dispozitën e falimentimit me kreditorët dhe të kërkojnë leje nga gjykata para marrjes së çdo veprimi i cili është jashtë kursit të zakonshëm të biznesit.

Sipas dispozitave mbi Riorganizimin, debitorit i lejohet që të mbetet në posedim të pasurive të tij dhe të vazhdojë funksionimin. Kreditorët të cilët kanë interes nga aftësia e debitorit për të ruajtur vlerën e pasurisë mund të kërkojnë nga gjykata që të emërohet një Administrator për të marrë kontrollin. Kreditorët mund edhe të pushojnë rastin nëse ata besojnë se debitori është duke abuzuar procesin e falimentimit (Lindsey Simon, 2019).

Ligji për Falimentimin krijon një komitet të kreditorëve – të cilët nuk kanë asete dhe të cilët mbështesin kërkesat e tyre – për të avokuar në emër të pretenduesve të cilët me gjasë nuk janë të përfshirë në rastin. Këto dhe karakteristika të tjera i japin një shkallë të drejtësisë një situatë qenësish të padrejtë. Debitori mund të jetë ulur në karrigen e vozitësit, mirëpo shumë akterë të tjerë relevant kanë kompetencën që të sigurojnë se kompania respekton rregullat e rrugës (Lindsey Simon, 2019).

Nëse kompanitë nuk janë në gjendje të tejkalojnë vështirësitë e tyre financiare apo operacionale, riorganizimi nuk do të sigurojë ringjallje mirëpo vetëm do të shtyjë rënien e pashmangshme, shpesh në kurriz të vlerës e cila mund të rikuperohet nga likuidimi i menjëhershëm. Sipas ligjit, likuidimi nënkupton procesin përmes së cilit kompanitë (apo pjesë të tyre) janë mbyllur,

me anë të së cilës asetet dhe pronat e saj janë rishpërndarë deri në masën e vlerës së rikuperuar nga shitja (arkëtimi) e aseteve të kompanisë. Likuidimi mund gjithashtu të nënkuptohet si përfundimi apo shpërbërja, edhe pse shpërbërja në kuptimin teknik është në fazën finale të likuidimit.

Leximi dhe Interpretimi i Ligjit të ri të Falimentimit në Kosovë

Ligji i Ri për Falimentimin është strukturuar në nëntë kapituj, çka mundëson lëvizje dhe kuptim më të lehtë:

KAPITULLI 1 – Dispozitat e Përgjithshme, Çështjet Administrative dhe Përkufizimet;

KAPITULLI 2 – Procedurat e Përsheptuara për Lehtësirat ndaj Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe për Planet e Para – Dakorduara;

KAPITULLI 3 – Inicimi i Procedurës dhe Hapja e Rastit;

KAPITULLI 4 – Pasojat Juridike të Hapjes së Rastit;

KAPITULLI 5 – Kërkesat e Kreditorëve;

KAPITULLI 6 – Riorganizimi;

KAPITULLI 7 – Likuidimi;

KAPITULLI 8 – Lirimi nga Borxhet dhe Mbyllja e Rastit;

KAPITULLI 9 – Dispozitat e Falimentimit Ndër Kufitar;

Parimet e Përgjithshme të Ligjit të Ri për Falimentimin

Parimet e përgjithshme të Ligjit të Ri për Falimentimin janë renditur në Nenin 4.1. Drejtimi i dhënë nga këto parime do të udhëheqë Gjykatën në interpretimin dhe aplikimin e Ligjit të ri për Falimentimin. Ato janë organizuar në tri grupe: Parimet të cilat rregullojnë procedurat e likuidimit, ato të cilat rregullojnë procedurën e riorganizimit dhe parimet e përgjithshme të falimentimit.

Në një Procedurë të Likuidimit, kompania pushon gjitha veprimet dhe del nga biznesi. Punëtorët pushohen nga puna, dhe ata të cilëve iu detyrohen pagat dhe beneficionet bëhen kreditorë. Një Administrator emërohet për të likuiduar (shitur apo ndryshe të zvogëlojë asetet në para të gatshme) gjitha asetet dhe pronat e kompanisë dhe të shqyrtojë kërkesat e dorëzuara nga kreditorët e kompanisë. Administruesi i besuar përdor gjitha parat e gatshme që kompania ka, të holla të gjeneruara nga shitja e aseteve dhe të ardhurat e çdo procesi gjyqësor të filluar në emër të kompanisë, për të paguar shpenzimet e administrimit të rastit dhe më pas, deri në masën e fondeve në dispozicion, të bëjë shpërndarjen e pagesave për kreditorët me kërkesa të aprovuara apo të lejuara, përfshirë punëtorët me paga dhe beneficione të papaguara, sipas rendit të përparësisë të përcaktuar në Ligjin e Falimentimit. Kërkesat e siguruara paguhen fillimisht, pastaj shpenzimet e administrimit të falimentimit, pastaj kërkesat e pasiguruara të prioritetit, të cilat mund të përfshijnë gjitha apo një pjesë të pagesave dhe beneficioneve të punëtorëve dhe në fund, kërkesat e përgjithshme të pasiguruara (City Bar Justice Center; New York City Bar, 2016). Në mënyrë që të arrihet kjo, Ligji për Falimentimin vendos disa parime të cilat rregullojnë procedurat e likuidimit, të cilat përfshijnë:

- Urgjenca e procedurave;
- Suspendimi apo ndërprerja e procedurave nuk është lejuar;
- Maksimizimi i kthimit të përgjithshëm të kreditorëve;
- Shpërndarja sipas parimit të barabartë të Pari Passu tek kreditorët e aksioneve;
- Kur debitori është një subjekt ligjor, ai nuk do të jetë pronar i aseteve të tij në përfundimin e procedurave të likuiditetit dhe do të largohet si biznes aktiv nga ARBK;
- Kur debitori është një individ, ai/a jo nuk do të jetë pronar i aseteve të biznesit të tij/saj të administruar në procedurat e falimentimit, në përfundim të procedurave të likuidimit;
- Kur një debitor individual ka falimentuar, kjo do të regjistrohet në regjistrin biznesor në çdo regjistrim të ri të ndonjë biznesi nga debitori dhe nga anëtarët e ngushtë të familjes për pesë (5) vite nga data e përfundimit të procedurave të falimentimit dhe fakti që debitori individual ka falimentuar do të shënohet në Regjistrin e Kredive të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;

Në një Procedurë të Riorganizimit, Kompania mbetet në biznes dhe përpiqet që të riorganizojë veten dhe të dal nga falimentimi si një kompani me financa të qëndrueshme. Shumë punëtor mund të mbesin në punë dhe vazhdojnë të paguhen dhe të pranojnë beneficione. Megjithatë, disa prej tyre mund të pushohen nga puna. Nëse punëtorëve të pushuar nga puna iu detyrohen pagat dhe beneficionet ata bëhen kreditorë të kompanisë. Menaxhmenti i kompanisë zakonisht mbetet në kontroll, mirëpo duhet të merr aprovimin nga Gjykata për pothuajse gjitha vendimet e rëndësishme afariste (City Bar Justice Center; New York City Bar, 2016). Qëllimi i Riorganizimit është që kompania të merr hapa gjatë falimentimit për të kthyer veten financiarisht, për shembull, nga shitja e asetëve dhe mbyllja e lokacioneve të biznesit, dhe pastaj të konfirmojë një plan të riorganizimit i cili lejon që kompania të del nga falimentimi me borxh të ristrukturuar dhe me biznes të shëndetshëm financiar. Kreditorëve iu jepet mundësia që ta votojnë planin e kompanisë para se gjykata të konsiderojë konfirmimin e tij. Nën rrethana të caktuara, komiteti i kreditorëve apo edhe kreditorët individual mund gjithashtu të propozojnë plane konkurruese nëse ata nuk pajtohen me propozimin e planit të kompanisë. Nëse bëhet e qartë se kompania nuk do të jetë në gjendje që të konfirmojë një plan të riorganizimit, kompania mund të propozojë një plan të likuiditetit apo të konvertojnë rastin në Likuiditet. Në përputhje me këtë, Ligji ka vendosur dy parime të cilat qeverisin procedurat e riorganizimit:

- Minimalisht të ruhen vendet e punës, apo të krijohen vende të reja pune;
- Mirëmbahet apo ruhet vlera e asetëve;

Parimet udhëheqëse të të gjitha procedurave:

- Nuk zhvlerësohen të drejtat e kreditorëve apo detyrimet e debitorëve, përjashtimisht nëse parashihet ndryshe në Ligj;
- Nuk zhvlerësohen apo ndryshohen të drejtat sendore të kreditorëve të siguruar apo kreditorëve të tjerë;
- Përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit, do të merr në posedimin e tij gjitha asetet, të prekshme ose të pa prekshme, subjekt i të gjitha të drejtave dhe kërkesave;
- Dhe në rastet e debitorëve individual, vetëm ato asete të shfrytëzuara, apo të dhëna peng, në mbështetje të biznesit të debitorit;
- Kërkesat maturohen në datën e hapjes së rastit;
- Respektimi i parimit të përgjegjësisë së kufizuar së aksionarëve dhe ortakëve të kufizuar, përjashtimin në rastet kur ekziston një punë juridike apo një garancion që rregullon përgjegjësinë e kufizuar.

Përkufizimet

Në shikim të parë, Ligji për Falimentimin përdor disa koncepte dhe terme të cilat mund të mos jenë të njohura për të gjithë përdoruesit e tij, kryesisht për shkak të mungesës së praktikave në këtë fushë. Neni 3, dhe nenet pasues të ligjit ofrojnë sqarime të secilit koncept, përpos për konceptin e Shoqërive Tregtare për të cilin Ligji për Falimentimin i referohet Ligjit në fuqi të Shoqërive Tregtare. Ato ofrojnë një të kuptuar specifik për këto koncepte brenda ligjit. Është e rëndësishme parësore për të ndjekur këto përkufizime gjatë leximit të ligjit në mënyrë që i njëjti të interpretohet me saktësi.

Fushëveprimi i aplikimit

Neni 2 përkufizon Fushëveprimin e aplikimit të Ligjit. Çdo organizatë e biznesit mund të jetë një debitor (shih faqen 13, pjesa A e këtij Manuali për përkufizimin e organizatave biznesore), me përjashtim të entiteteve të cilat shprehimisht janë përjashtuar në Nenin 6.2 të ligjit të ri, për shkak të ekzistencës së procedurave të posaçme të falimentimit për këto entitete.

Procedura të ndara nga fushëveprimi i këtij ligji do të aplikohen:

- Për gjitha llojet e institucioneve financiare (Bankat, Kompanitë e Sigurimit, Institucionet Financiare jo Bankare, Institucionet Mikro-Financiare dhe Fondet Pensionale) sipas Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare jo Bankare, Ligji Nr. 05/L-045 për Sigurime dhe Ligji Nr. 04/L-018 për Fondet Pensionale në Kosovë (të ndryshuar dhe plotësuar);
- Për Ndërmarrjet Shoqërore, sipas Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë e Privatizimit të Kosovës (të ndryshuar dhe plotësuar) dhe Ligjit Nr. 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre.

Nuk ka procedura të vendosura për Falimentimin e Ndërmarrjeve Publike, megjithatë, ato përjashtohen nga aplikimi i Ligjit për Falimentimin në Kosovë.

Juridiksioni Gjyqësor dhe Mjetet Ligjore

Neni 8 i Ligjit të Falimentimit i jep juridiksion ekskluziv Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë si gjykatë e shkallës së parë, përderisa gjitha ankesat trajtohen nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës së Apelit.

Departamentet e tjera dhe Gjykatat e tjera në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë nuk do të ushtrojnë juridiksion për ndonjë procedurë të falimentimit.

Mjetet e jashtëzakonshme juridike në dispozicion në procedurat civile (sikurse Rishikimi me Gjykatën Supreme dhe Kërkesa për të rihapur një rast) nuk lejohen sipas Ligjit të Falimentimit dhe gjithë procedura sipas mjeteve ligjore përfundon në Departamentin e Çështjeve Komerciale të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

Edhe pse ankesat lejohen si mjete ligjore, duhet të mbahet në mend se një ankesë nuk mund të depozitohet për secilën kërkesë mbi të cilën një vendim është marrë nga Gjykata Themelore. Kjo është kryesisht për faktin se ligji siguron që procedurat e falimentimit janë procedura urgjente, që nuk lejohet asnjë suspendim apo ndërprerje e procedurave dhe që është e nevojshme të mirëmbahet apo të ruhet vlera e aseteve, në përputhje me parimet e Ligjit për Falimentim të parapara në Nenin 4 të Ligjit. Për më tepër, Neni 8, paragrafi 5 i Ligjit për Falimentimin parasheh që një ankesë kundër një vendimi të një gjykate të instancës së parë nuk pengon asnjë veprim procedural të urdhëruar nga Gjykata, përpos nëse Gjykata e Apelit merr vendim ndryshe. Gjykata e Apelit ka 15 ditë kohë të vendos për secilën çështje e cila lidhet me Procedurat e Falimentimit.

Kapitulli II:

Pjesëmarrësit kryesor dhe palët me interes në një Procedurë Falimentimi

Megjithëse shumë persona dhe lloje të entiteteve mund potencialisht të luajnë role kritike në një procedurë falimentimi, të tillë sikurse një palë me interes, përfshirë debitorin, përfaqësuesin e pasurisë së falimentimit, komitetin e kreditorëve, një mbajtës të kapitalit, një kreditor, apo çdo **përfaqësues të pasurisë së falimentimit**, dhe të cilët mund të ngritën apo paraqiten apo të dëgjohen për ndonjë çështje, në shumicën e llojeve të rasteve të falimentimit, disa pjesëmarrës në procesin e falimentimit janë posaçërisht të rëndësishëm. Pjesëmarrësit kryesor në secilin rast janë **debitori** (i cili kërkon lehtësim nga borxhet të cilat nuk mund ti shlyejë), dhe **kreditorët** (të cilët kërkojnë që në mënyrë të shpejtë dhe efikase të mbledhin sa më shumë që të ketë mundësi borxhet e tyre) (Kevin M. Lewis, 2018).

Gjithë palët me interes në një procedurë të falimentimit, përpos Gjykatësit, referohen si “Palë me Interes” dhe përkufizohen sipas Neni 3, paragrafit 1, nën paragrafit 1.35 si “debitorë, administratorë të falimentimit, kreditorë, mbajtës të kapitalit, komitete të kreditorëve, dhe njësi qeverisëse. Entitetet me interesa të largëta apo të shpërndara jo-pasurore nuk konsiderohen palë me interes. Pala me interes nënkupton secilën palë:

- të drejtat obligimet dhe interesat e tjera pasurore apo monetare të të cilëve afektohen nga procedurat e falimentimit apo çështje specifike në procedurë falimentimi; apo
- detyrat ligjore të të cilit përfshijnë monitorimin apo administrimin e procedurave të falimentimit.

A. Debitori

Neni 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.18 i Ligjit për Falimentimin përkufizon Debitorin si një entitet kundrejt së cilit iniciohet procedura e falimentimit sipas Ligjit të Falimentimit. Neni 6 i Ligjit të Falimentimit tutje përcakton se çdo Shoqëri Tregtare mund të jetë një Debitor. Neni 5 i Ligjit Nr. 06/L-016 i Shoqërive Tregtare në Kosovë (“Ligji për Shoqëritë Tregtare) parasheh pesë forma të ndryshme të bizneseve, dy forma të përfaqësimit të bizneseve të huaja në Kosovë dhe dy forma të kompanive të cilat janë ose në pronësi publike ose shoqërore:

1. Biznes Individual;
2. Ortakëri e Përgjithshme;
3. Ortakëri e Kufizuar;
4. Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ; dhe
5. Shoqëri Aksionare;
6. Degë e Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë;
7. Zyra e Përfaqësisë së Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë;
8. Ndërmarrjet Publike sipas Ligjit në fuqi për Ndërmarrjet Publike; dhe
9. Ndërmarrjet Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Bazuar në Nenin 6, paragrafi 2, i Ligjit për Falimentimin, format e bizneseve të renditura në pikat 8, 9 dhe subjektet e mëposhtme NUK MUND të jenë debitorë:

- Republika e Kosovës;
- Institucionet Publike
- Asnjë “Institucion Financiar” siç përcaktohen sipas Ligjit i cili rregullon Bankat, Institucionet Mikro Financiare dhe Institucionet Financiare Jo Bankare;
- Asnjë “Kompani e Sigurimeve” apo “Ndërmjetës i Sigurimeve” i licencuar dhe rregulluar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- Asnjë “Fond Pensional” apo ofrues i skemave pensionale i licencuar dhe rregulluar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- Ndërmarrjet shoqërore dhe ndërmarrjet nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Ndërmarrjet publike të përcaktuara sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike apo sipas ndonjë ligji të ardhshëm.

Ligjet të cilat qeverisin falimentimin e subjekteve të cilat nuk janë debitorë të kualifikuar bazuar në Ligjin për Falimentimin janë paraparë në Kapitullin II – Fushëveprimi i Aplikimit, pjesë e këtij Manuali.

B. Kreditorët dhe Komiteti i Kreditorëve

Komiteti i Kreditorëve është trupi përfaqësues i cili mbron interesat e kreditorëve dhe monitoron administrimin e një rasti të falimentimit.

Bazuar në Nenin 67 të Ligjit për Falimentimin, **Komiteti i Kreditorëve në një Procedurë të Riorganizimit** ka disa të drejta dhe detyrime, të cilat janë:

- pranon kopje të raportit mujor nga administratori në të njëjtën kohë me gjykatën;
- pranon njoftimet për mocione dhe kërkesa të tjera për veprimet e Gjykatës të cilat në mënyrë substanciale afektojnë të drejtat e kreditorëve;
- thërret në seancë debitorin apo përfaqësuesit e debitorit, të cilët obligohen që ti përgjigjen pyetjeve sa i përket debitorit;
- shpërndan informacionin e marr nga kreditorët të cilët nuk janë anëtarë të bordit;
- përgatit rekomandime për planin e riorganizimit për të cilin kreditorëve do t’iu kërkohej që të votojnë;
- çfarëdo obligimi apo të drejta të tjera të parapara qoftë në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar sipas ligjit.

Bazuar në Nenin 91 të Ligjit për Falimentimin, **Komiteti i Kreditorëve në një Procedurë të Likuidimit** përbëhet nga të paktën 3 dhe jo më shumë se 5 kreditorë, me prioritet të dhënë kreditorëve me kërkesat më të mëdha të pagjdhura. Nëse ka më pak se 3 kreditorë të tillë të cilët dëshirojnë të shërbejnë në ndonjë komitet, atëherë komiteti nuk do të themelohet. Të drejtat dhe detyrimet e komitetit të kreditorëve përfshijnë:

- pranon kopje të të gjitha shkresave që i drejtohen gjykatës nga debitorin në posedim, në të njëjtën kohë me gjykatën;
- punëson profesionistë sipas kushteve dhe kufizimeve të njëjta për punësimin e profesionistëve nga Administratori;
- pranon njoftimet nga Gjykata dhe vendimet e Gjykatës të cilat ndikojnë në të drejtat e kreditorëve;
- thërret në seancë debitorin apo përfaqësuesit e tij të cilët janë të obliguar që ti përgjigjen pyetjeve të komitetit të kreditorëve sa i përket rastit¹;
- me aprovim të gjykatës, pas njoftimit se Administratori nuk do të ndërmarrë një veprim të tillë, inicion një veprim për të shmangur bartjen sipas Kapitullit IV të Ligjit për Falimentimin;

¹ Bazuar në nenin 91, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.4, secila përgjigje e debitorit apo e përfaqësuesve ti tij do të konsiderohet si deklaratë nën betim.

- shpërndan informacionin e marrë nga kreditorët të cilët nuk janë anëtarë të komitetit; dhe
- çfarëdo të drejte dhe obligimi tjetër që mund t'ia caktoj gjykata.

C. Përfaqësuesi i Pasurive të Falimentimit.

Ndryshe nga Ligji i vjetër, koncepti i ri i Përfaqësimit të Pasurisë së Falimentimit është prezantuar në Ligjin e Ri për Falimentimin, së bashku me mundësinë që Debitori të jetë në posedim të Pasurisë. Si rrjedhojë, me Ligjin e ri, ekzistojnë tre grupe të funksioneve brenda Përfaqësimit të Pasurisë së Falimentimit, varësisht nëse rasti i falimentimit është një rast i riorganizimit apo rast i likuidimit:

1. Debitor në Posedim
2. Administrator i Falimentimit
3. Monitorues (Administrator i Falimentimi i emëruar si monitorues, në rastet kur debitori është në posedim).

Në një procedurë të likuidimit, administratori i falimentimit do të jetë përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit. Në një procedurë të riorganizimit, debitori është përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit kur vepron si një debitor në posedim. Në rastet kur gjykata emëron një Administrator të Falimentimit, administratori duhet të jetë përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit në riorganizim. **Administratori i Falimentimit dhe Monitoruesi i Falimentimit**

Në një **Procedurë të Likuidimit**, administratori luan një rol qendror dhe shumë planësh në administrimin e organizimit të biznesit në falimentim dhe pasurinë e falimentimit. Pasi atij/asaj i janë dhënë kompetenca vendimmarrëse, administrative dhe menaxheriale, vendimet më të rëndësishme të vendosura nga administratori janë subjekt i shqyrtimit nga gjykata e falimentimit, përderisa të drejtat për t'iu qasur informacionit dhe marrjes së dokumenteve apo shmangien e bartjes nëse Administratori refuzon të shmangë një bartje të tillë i janë dhënë komitetit të kreditorëve²³.

Përgjegjësitë e përgjithshme të Administratorit përfshijnë:

- Realizon të hyra nga pronat e pasurisë falimentuese të cilat janë nën administrimin e tij dhe realizon të hyrat nga pasuria falimentuese sa më shpejtë që është e mundur, në interes të të gjitha palëve të interesuara;
- Do të jetë përgjegjës për gjitha pronat që i pranon;
- Do të thërret dhe udhëheq të gjitha takimet e komitetit të kreditorëve;
- Rishikon të gjitha çështjet financiare të debitorit;
- Me qëllim të realizimit të objektivave, mund të hetoj provat e kërkesave dhe kundërshtoj lejimin e një kërkesë të papërshtatshme;
- Nëse është e këshillueshme, të kundërshtojë lirimin e debitorit nga borxhet;
- Përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe, të jap informata mbi pasurinë falimentuese dhe administrimin e pasurisë falimentuese ashtu siç kërkohet nga ndonjë palë e interesit; dhe
- Përgatit raportin final dhe dorëzon raportin final mbi administrimin e pasurisë në gjykatë.

Në një **Procedurë të Riorganizimit të NVM-ve** sipas Kapitullit II të Ligjit për Falimentimin, i cili është i zbatueshëm në rastet kur NVM është një debitor falimentues (NVM siç përkufizohet në Nenin 11 të Ligjit për Falimentimit) gjykata do të vendos një monitorues. Gjykata mund të përzgjedh monitoruesin nga radhët e Administratorëve të pranueshëm. Detyrat e Monitoruesit përfshijnë:

- Këshillohet me debitorin sa i përket biznesit të debitorit, perspektivat e tij dhe mundësinë e përgatitjes së një plani i cili do të jetë i pranueshëm për kreditorët.
- Shqyrton secilin plan të propozuar nga Debitori NVM me qëllim të vlerësimit se a ofron plani qëndrueshmëri ekono-

² Detyrat dhe të drejtat e Komitetit të Kreditorëve në rastin e riorganizimit janë renditur në Nenin 67, paragrafi 3, të Ligjit për Falimentimin;

³ Detyrat dhe të drejtat e Komitetit të Kreditorëve në rastin e likuidimit janë renditur në Nenin 91, paragrafi. 3 të Ligjit për Falimentimin;

mike. Shqyrtimi i planit mund të ndodh para ose pasi që debitori ia paraqet planin gjykatës.

- Mbikëqyrë implementimin e planit pas miratimit të tij dhe paraqet raporte me shkrim tek Gjykata për implementimin e planit.

Votimi i Planit të Riorganizimit të NVM kërkon që debitori të informojë monitoruesin për atë vendim, dhe monitoruesi pastaj do të ketë dhjetë (10) ditë që ti paraqesë gjykatës raportin që përfshinë opinionin e monitoruesit mbi realizueshmërinë e planit. Nëse Monitoruesi nuk e dorëzon raportin për planin, gjykata konsideron se monitoruesi është pajtuar me planin.

Në **Procedurat e Riorganizimit** në përgjithësi (përfshirë Procedurat e Riorganizimit të NVM), debitori do të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese kur vepron si **debitor në posedim**. Ndryshe prej një Procedure të Likuidimit, në të cilin Administratori administron pasurinë e debitorit me qëllim që të përmbush kërkesat e kreditorëve, një debitor i riorganizimit përgjithësisht mbetet në posedim të aseteve të tij përgjatë gjithë procedurave të riorganizimit dhe i administron ato për të mirën e Procesit. Kur vepron në këtë kapacitet, debitori njihet si “debitor në posedim”. Me disa përjashtime, debitori në posedim mund përgjithësisht të hyjë në transaksione dhe të përdor pronën pasurore në rrjedhën e zakonshme të biznesit (Kevin M. Lewis, 2018) (të tilla veprime të parapara në Nenin 33, paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit për Falimentimin). Megjithatë, çdo veprim i debitorit në posedim që ndërmerret jashtë rrjedhës së zakonshme të biznesit kërkon njoftim, seancë dëgjimore apo miratim paraprak nga gjykata. Veprimi “jashtë rrjedhës së zakonshme të biznesit” përfshin çdo transaksion i cili mund të konsiderohet i pazakontë, kontrovers, apo i diskutueshëm për debitorin përgjatë rastit të tij të riorganizimit, sikurse shitja e aseteve të debitorit (Kevin M. Lewis, 2018). Neni 3, paragrafi 3, nën paragrafi 1.33 i Ligjit për Falimentimin përcakton se rrjedhat e zakonshme të biznesit janë transaksione dhe veprime të cilat kanë qenë të rregullta për debitorin para paraqitjes së kërkesës së tij për falimentim dhe kushtet e zakonshme të afarizmit në të cilat debitori afaron.

Në rastet kur gjykata emëron një Administrator të Falimentimit, Administratori duhet të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese në riorganizim. Në përputhje me Nenin 64 të Ligjit për Falimentimin, debitori do të shërbejë si debitor në posedim në një rast të riorganizimit përveç nëse debitori kërkon emërimin e një Administratori, ose në kohën e fillimit të procedurave të falimentimit apo më vonë; apo nëse gjykata largon debitorin në posedim.

Emërimi i administratorit

Gjykata emëron⁴ një Administrator jo më vonë se tre (3) ditë, në rastet në vijim:

1. pas dorëzimit të kërkesës për një rast të likuidimit nga debitori;
2. pas hapjes së procedurës së likuidimit pas paraqitjes së një kërkesë të falimentimit nga kreditorët;
3. pas shndërrimit të riorganizimit në likuidim;
4. pasi gjykata vendos të largojë debitorin në posedim apo një Administrator të emëruar më herët.

Administratori emërohet nga lista e Administratorëve të Falimentimit e cila mirëmbahet nga Ministria e Drejtësisë në Kosovë. Gjithë kandidatët të cilët janë pjesë e listës konsiderohet se janë të kualifikuar sipas Ligjit për Falimentimin. Megjithatë, Ligji i ri parashih gjithashtu mundësinë për të angazhuar Administratorë ndërkombëtarë, me kushtin që ata të jenë anëtarë të shoqatave profesionale të falimentimit në Kosovë, në Bashkimin Evropian apo në Shtetet e Bashkuara. Një Administrator ndërkombëtarë do të bëhet pjesë e listës së mirëmbajtur nga Ministria e Drejtësisë duke ofruar dëshmi të anëtarësisë së tyre në shoqatat profesionale tek Ministria.

4 Shih Shtojcën 6 Vendimi për Emërimin e Administratorit

Përgjegjësitë e Administratorit

Ligji i ri shprehimisht parasheh që Administratori nuk do të mbahet personalisht përgjegjës për humbjet e shkaktuara nga një kreditor, një debitor, ndonjë aksionar apo partner, pasuria falimentuese, apo ndonjë palë tjetër, për pasojat apo dëmtimet të cilat rrjedhin nga vendimet e bëra apo veprimet e ndërmarra apo jo të ndërmarra brenda fushëveprimit të detyrave të tij nëse ai ka ushtruar kujdesin dhe zellin e zakonshëm në përmbushjen me kohë të atyre detyrave.

Shkarkimi i Administratorit

Nëse Gjykata e shih të nevojshme dhe të arsyeshme, ajo vendos për shkarkimin e Administratorit nga rasti konkret. Arsye për shkarkim⁵, sipas Ligjit për Falimentimin, do të konsiderohet, por nuk kufizohet në vetëm:

- dëshmi se Administratori nuk i plotëson kualifikimet sipas Ligjit; apo
- dëshmi se Administratori ka kryer ndonjë veprë penale apo ka mashtruar gjatë administrimit të rastit, rrethana të cilat e vejnë në pikëpyetje integritetin moral dhe ndershmërinë e Administratorit;
- me votimin e shumicës së kreditorëve për shkarkimin e administratorit të rastit, në një mbledhje të veçantë të kreditorëve të thirrur vetëm me qëllim të shkarkimit të Administratorit, ose kryerjen e pakënaqshme të detyrave të administratorit.

Shkarkimi i Debitorit në Posedim

Siç parashihet në Nenin 66 të Ligjit për Falimentimin, Gjykata mund të shkarkojë debitorin në posedim sipas kërkesës së vet debitorit apo sipas kërkesës së një pale të interesuar nëse ka dëshmi se:

- debitori ka mashtruar, ka vepruar jo ndershmërisht ose me keqbesim para ose pas hapjes së rastit;
- debitori nuk mund të menaxhojë çështjet financiare të tij në mënyrë profitabile;

shumica e kreditorëve aktiv në rast tregojnë se ata dëshirojnë të largojnë debitorin në posedim.

Kompensimi i administratorit

Administratori do të paguhet bazuar në shpërndarjet e bëra tek kreditorët. Pagesa të tilla do të konsiderohen si shpenzime administrative. Gjykata duhet të aprovojë kompensimin dhe shpenzimet e Administratorit para se Administratori të jetë paguar, bazuar në shpërndarjen tek Kreditorët. Kompensimi i Administratorit për shërbimet e parashikuara do të paguhet vetëm pasi shërbimet e tilla janë dhënë dhe Gjykata ka lëshuar vendim për një kompensim të tillë. Gjykata do të lejojë pagesat në përputhje me vlerën totale të shpërndarjeve të cilat Administratori i bën tek palët me interes, përjashtuar këtu debitorin, mirëpo duke përfshirë mbajtësit e kërkesave të siguruara bazuar në shumat në vijim:

- njëzet e pesë për qind (25%) e shumës deri në pesë mijë (5,000) Euro;
- dhjetë për qind (10%) e shumës nga pesë mijë e një (5,001) Euro deri në pesëdhjetë mijë (50,000) Euro;
- pesë për qind (5%) e shumës nga pesëdhjetë mijë e një (50,001) Euro deri në një milion (1,000,000) Euro;
- tre për qind (3%) e shumave mbi një milion (1,000,000) Euro;
- në secilin rast, Administratori do të pranojë një tarifë minimale prej njëqind (100) Euro për secilin rast në të cilin ai/ ajo ka shërbyer si Administrator i Falimentimit.

5 Shih Shtojcën 7 Vendimi për Shkarkimin e Administratorit

D. Gjyqtari.

Neni 8 i Ligjit për Falimentimin i jep juridiksion ekskluziv Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore të Prishtinës si gjykatë e shkallës së parë, përderisa gjitha ankesat trajtohen nga Departamenti për Çështje Ekonomike të Gjykatës së Apelit.

Gjykata përbëhet nga një gjyqtar i vetëm kur procedon një rast të falimentimit. Gjyqtari i vetëm shpesh referohet si Gjyqtari i Falimentimit në përmbajtjen e këtij Manuali. **Gjyqtari** i Falimentimit kryeson procedurat e falimentimit; shqyrton dhe merr vendime sa i përket kërkesave të dorëzuara nga pjesëmarrësit në rastin e falimentimit; zgjedh lloje të ndryshme të mosmarrëveshjeve në mes të palëve; dhe kryen detyra të tjera të ngjashme (Kevin M.Lewis, 2018).



Kapitulli III.

Inicimi i Procedurës së Falimentimit.

A. Palët e lejuara për të aplikuar për riorganizimin dhe likuidim

Debitori në një Falimentim Vullnetar

Rasti i falimentimit vullnetar fillon me paraqitjen e një kërkesë në Gjykatë nga Debitori. Debitorit i kërkohet që të dorëzojë skedarët e aseteve dhe detyrimeve, të hyrat aktuale dhe shpenzimet, pasqyrat e financave, të dhënat e kontratave përmbarimore dhe të tjera me dorëzimin e kërkesës vullnetare (Lawson, 2020). Për iniciimin e vullnetshëm të rastit, debitori dorëzon ose një kërkesë për riorganizim ose një kërkesë për likuidim⁶.

Kreditorët në Falimentimin jo vullnetar

Secili prej dy (2) Kreditorëve fillon një rast të falimentimit jo vullnetar duke paraqitur një kërkesë në Gjykatë. Debitori ka mundësinë që të paraqesë kundërshtimet e tij. Gjykata duhet shpejtë të njoftojë debitorin brenda tre (3) ditëve që nga dorëzimi i kërkesës për iniciimin e procedurës së falimentimit. Nëse kjo ndodh, gjykata lëshon një vendim mbi pranueshmërinë e kërkesës dhe urdhëron hapjen e rastit. Nëse jo, procedurat e falimentimit vazhdojnë⁷. Kufijtë e mëposhtëm duhet të plotësohen me qëllim që Gjykata të hapë Procedurat e Falimentimit bazuar në kërkesën e Kreditorëve:

1. Debitori ka dështuar të paguajë borxhin me detyrim për secilin kreditorë aplikues, dhe secilit borxh i ka kaluar afati i pagesës prej të paktën nëntëdhjetë (90) ditë;
2. Shuma totale e detyrimit është të paktën në vlerë prej tremijë (3,000) Euro; dhe
3. Secili detyrim është detyrim pa kushte apo nuk është në procedurë kontestimore pran një gjykate ose në procedurë të arbitrazhit; dhe
4. Debitori përgjithësisht nuk është duke i paguar borxhet pas arritjes së afatit të pagesës, dhe borxhi total i detyrimeve të papaguara ka tejkaluar pesëmijë (5,000) Euro.

⁶ Neni 19 i Ligjit për Falimentimin parasheh gjitha detajet e rasteve vullnetare të iniciuara nga Debitori.

⁷ Neni 20 i Ligjit për Falimentimin parasheh gjitha detajet e rasteve vullnetare të iniciuara nga Debitori.

B. Inicimi i procedurës

Formati i kërkesës për iniciimin e procedurave të falimentimit është dhënë në Shtojcën 1.⁸ Përpos kërkesës, Debitori duhet gjithashtu të dorëzojë informacione për asetet dhe detyrimet e debitorit; informata për të hyrat dhe shpenzimet aktuale të Debitorit; pasqyrat e financave të debitorit; dhe dokumente të tjera të kërkuara siç parashihet me Ligj. Këto kërkesa për dorëzim janë hartuar për të nxjerr informata të caktuara të nevojshme për të bërë administrimin dhe gjykimin e duhur të rastit dhe për të siguruar se ka informata adekuate në dispozicion për kreditorët e debitorit, për të lehtësuar shpërndarjen e lehtë dhe efikase të të ardhurave dhe asetëve të debitorit, si dhe për administrimin e duhur të procedurave të falimentimit. Varësisht nga rrethanat financiare të debitorit, debitorit mund gjithashtu ti kërkohej që të paguajë një tarifë depozitimi (Kevin M. Lewis, 2018).

Eksiton një numër kërkesash të vendosura për paraqitjen dhe mbështetjen e kërkesës për falimentim.

Përmbajtja e Kërkesës së paraqitur nga Debitori

Ligji specifikon përmbajtjen e kërkesës, ndërsa pamja e formës dhe formulimi i sugjeruar është dhënë në Shtojcën 1 të cituar më sipër. Në përmbledhje, Kërkesa për Inicimin e Rastit duhet të përmbajë së paku:

- Emrin e debitorit, dhe të gjithë emrat të cilat debitori i ka përdorur për të bërë biznes në pesë (5) vitet e fundit të cilat i paraprijnë datës në të cilën është paraqitur kërkesa;
- Të dhënat kontaktuese të debitorit, të cilat minimalisht duhet të përfshijnë adresën, numrin apo numrat e telefonit, numrin e identifikimit fiskal, numrin e regjistrimit të biznesit; email adresën dhe çdo adresë të ueb faqes për çdo ueb faqe të cilën e mirëmban; dhe
- Kur debitori është një subjekt juridik, gjitha informatat në dispozicion për zyrtarët, drejtorët, anëtarët, menaxherët apo entitetet e tjera me kontroll menaxherial apo tjetër mbi pronën e debitorit, së bashku me informatat e kontaktit për secilin prej tyre në përputhje me nën paragrafin paraprak;
- Listën e gjithë kreditorëve të njohur, me informatat e tyre kontaktuese për secilin prej tyre;
- Listën e të gjitha kërkesave të njohura kundër debitorit, së bashku me shumën e kërkesave, datën e përafërt kur është bërë, dhe nëse kërkesa është e diskutueshme, e kushtëzuar apo e pjekur;
- Listën e të gjitha asetëve të debitorit së bashku me një parashikim të mirë besuar të vlerës së secilit aset. Nëse një aset është i prekshëm, debitori do të tregojë se ku mund të gjendet aset; nëse aset i nuk është i prekshëm, debitori do të tregojë detyruesin, nëse ka, në lidhje me aktivin dhe informacionin e kontaktit të detyruesit;
- Listën e të gjitha transaksioneve jashtë rrjedhës së zakonshme të biznesit, në të cilët debitori ka qenë palë apo prej të cilave debitori ka përfituar, bëri apo transaktoi brenda dy viteve para fillimit të procedurave të falimentimit. Sa i përket secilit transaksion të tillë, debitori do të tregojë gjithashtu datën e transaksionit, dhe identitetin dhe informatat kontaktuese të të gjitha palëve të transaksionit (së bashku me një tregues nëse ndonjëra prej palëve të tilla është e brendshme); dhe
- Listën e gjitha transaksioneve të cilat përfshijnë shkëmbimin e vlerës më shumë se nëntëqind dhe nëntëdhjetë e nëntë (999) Euro, në të cilën debitori ishte palë apo prej të cilës debitori ka përfituar, i ka bërë brenda vitit që i ka paraprirë fillimit të procedurave të falimentimit. Sa i përket transaksionit të tillë, debitori gjithashtu do të tregojë datën e transaksionit, dhe identitetin dhe informatat kontaktuese të të gjitha palëve të transaksionit së bashku me një tregues nëse ndonjëra prej palëve të tilla ishte një palë e brendshme.

8 Shih Shtojcën 1: Kërkesa për Inicimin e Rastit

Përmbajtja e kërkesës së paraqitur nga Kreditorët

Nëse kreditorët paraqesin një kërkesë të falimentimit, ata gjithashtu duhet të paraqesin në kërkesë sa më shumë informacione që kërkohet të paraqiten nga Debitori, për aq sa dinë apo mund të konstatojnë në mënyrë të arsyeshme.

Nëse kërkesa për falimentim e kreditorëve për hapjen e një rasti të falimentimit pranohet nga Gjykata, debitori obligohet që ti sigurojë Gjykatës të gjitha informacionet të cilat Debitori do të kërkohej që ti depozitonte nëse Debitori do të ishte paraqitësi i kërkesës, dhe atë brenda dhjetë (10) ditëve nga hapja e rastit.

C. Kundërshtimet dhe provat

Aplikimi i Debitorit për Falimentim

Në rast se debitori paraqet kërkesën, arsyetimi për iniciimin sigurohet pasi që:

- Debitori merr aprovimin nga organi më i lartë menaxherial apo ndonjë trup tjetër menaxherial të përcaktuar në Statutin e Kompanisë apo në Ligjin për Shoqatat Afariste (shembull, dispozitat e Nenit 221, paragrafi 2 i Ligjit për Shoqëritë Aksionare i cili kërkon aprovimin e Asamblesë së Aksionarëve të Shoqatës Aksionare për iniciimin e Procedurave të Falimentimit apo Nenin 102, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 për Ndërmarrjet me Përgjegjësi të Kufizuar);
- Bazuar në ndonjë analizë të biznesit të tij, me gjasë në periudhën e ardhshme Debitori do të përballët me situatë të paaftësisë paguese (Neni 1, paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 dhe Neni 19, paragrafi 2 i Ligjit për Falimentimin) apo nëse situata e paaftësisë paguese ka ndodhur qartazi.

Aplikimi i kreditorëve për falimentim

Siç parashihet në Kapitullin 3, Pjesa A, dy apo më tepër kreditorë mund të paraqesin një kërkesë për falimentimin e ndonjë debitori nëse kushte të caktuara janë përmbushur.

Debitori mund ti rezistojë kërkesës jo vullnetare duke paraqitur një kundërshtim dhe duke demonstruar që përgjithësisht është duke paguar borxhet e tij sipas afatit kohor. Në rast se gjykata hedhë poshtë kërkesën jo vullnetare, mund të jap një gjykim kundër kreditorëve kërkues për kostot dhe tarifat e avokatëve të cilat i kanë ndodhur debitorit dhe për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga kërkesa.

D. Vendimet dhe Ankesat.

Administrimi i një Rasti të Falimentimit kryhet përmes seancave dëgjimore, të cilat duhet të ndodhin jo më vonë se shtatë (7) ditë nga data e pranimit të njoftimit nga palët.

Vetëm një Palë me interes e cila afektohet apo dëmtohet nga një vendim i lëshuar nga Departamenti i Çështjeve Komerciale i Gjykatës Themelore të Prishtinës do të ketë të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Një Palë me interes do të ketë të drejtë të ankohe kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës të cilat lidhen me çështjet përfundimtare të administrimit të rastit të falimentimit, brenda *shtatë (7) ditëve* nga data e pranimit të vendimit. Kjo gjithashtu është në përputhje me afatet e përgjithshme kohore të ankesave për mosmarrëveshje ekonomike, ashtu siç parashihet në Ligjin për Procedurën Kontestimore. Çdo ankesë e ngritur nga ndonjë Palë me Interes nuk e ndërpret asnjë procedurë në veprim të urdhëruar nga Gjykata Themelore e Prishtinës, përveç nëse Gjykata e Apelit vendos ndryshe.

Një dallim me një mosmarrëveshje tipike ekonomike është që Ligji për Falimentimin në Kosovë parasheh një afat kohor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve për Gjykatën e Apelit të vendos për çdo çështje.

Përdorimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike në Gjykatën Supreme të Kosovës nuk lejohet sipas Nenit 8, paragrafit 7 të Ligjit të Falimentimit.

Kapitulli IV.

Efektet e Inicimit të procedurës së Riorganizimit apo Likuidimit

Hapja e Rastit

Bazuar në Nenin 18 të Ligjit për Falimentimit, një rast hapet kur:

- Debitori paraqet një kërkesë për inicim vullnetar të riorganizimit apo likuidimit; apo
- Është paraqitur një kërkesë jo vullnetare kundër debitorit, dhe, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për njoftimin e debitorit, gjykata do të lëshojë aktvendim për të konstatuar se kërkesa përmbush gjitha kërkesat e Ligjit.

Hapja e Rastit krijon efektet e mëposhtme ligjore:

- Krijon pasurinë falimentuese;
- I jep Gjykatës juridiksion ekskluziv mbi pasurinë falimentuese dhe mbi debitorin;
- Vepron si ndalim i procedurave (zakonisht i njohur në juridiksionin e Kosovës si moratorium);

Në Procedura të Likuidimit, hapja e rastit gjithashtu:

- Zhvesh debitorin nga kontrolli i gjitha pronave të tij;
- Rezulton në emërimin e një Administratori;
- Kur Administratori nuk kërkohet, i jep debitorit gjitha kompetencat dhe detyra e debitorit në posedim; dhe
- Kur Administratori kërkohet, zhvesh debitorin nga kontrolli i gjitha pronave të tij dhe i jep kontroll Administratorit.

Pas hapjes së një rasti, gjykata do të:

- Njoftoj brenda dy (2) ditëve regjistrin e bizneseve, regjistrin e pengjeve, bankat komerciale, regjistrin e kredive në Bankën Qendrore dhe administratën tatimore për hapjen e rastit. Forma e njoftimit duhet të jetë me shkrim. Pas pranimit të njoftimit, regjistri i bizneseve, regjistri i pengjeve, bankat komerciale, regjistri i kredive dhe administrata tatimore do të shënojnë hapjen e rastit në regjistrat e tyre përkatës;
- Publikojë njoftimin në tabelën njoftuese të Gjykatës dhe në së paku dy (2) gazeta të shkruara.
- Vendos kohën, datën dhe vendin e takimit të parë të kreditorëve për një datë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hapjes së rastit; dhe
- Kur aplikohet, lëshojë një njoftim për emërimin e Administratorit dhe për datën, kohën dhe vendin e takimit të parë të kreditorëve;
- Vendos një seancë paraprake dëgjimore në gjykatë dhjetë (10) ditë pas caktimit të takimit të parë të kreditorëve për të përcaktuar statusin e rastit dhe rezultatet e takimit të kreditorëve. Gjykata urdhëron debitorin, apo përfaqësuesit e tij të autorizuar, që të marr pjesë në takim.

Krijimi i Pasurisë Falimentuese

Paraqitja e një kërkesë për falimentim në gjykatë krijon pasurinë falimentuese, e cila, nën disa përjashtime të caktuara, përbëhet nga prona e debitorit që nga fillimi i rastit. Asetet në pasurinë falimentuese përgjithësisht përdoren për të përmbushur kërkesat e kreditorëve dhe shpenzimet e procedurave. Çka është më e rëndësishme, megjithatë, disa lloje të pronave nuk përfshihen në pasuri apo mund ndryshe të largohen nga shtrirja e kreditorëve. Për shembull, prona që debitori e fiton pas paraqitjes së kërkesës së tij për falimentim është, me disa përjashtime, përgjithësisht pronë jo e pasurisë. Për më tepër, Ligji për Falimentimin

mund të lejojë një debitorë që të përjashtojë kategori të caktuara të asetëve nga pronat e pasurisë dhe në këtë mënyrë ti izolojë ato asetë nga kërkesat e kreditorëve. Për shembull, varësisht nga rrethanat, një debitor individual mund të jetë në gjendje që të kërkojë artikujt e veshjeve, pajisje të caktuara mjekësore, po asetet e tij personale si të përjashtuara nga kërkesat e kreditorëve në përputhje me Ligjin për Procedurën Përmbartimore siç parashihet në Nenin 108 të Ligjit për Falimentimin. Lejimi i debitorit si biznes individual që të kërkojnë asetë të caktuara si përjashtim i mundëson debitorit që të mbrojë pronën e cila është e nevojshme për mbijetesën e debitorit dhe të familjes së debitorit. Vini re, megjithatë, se një debitor jo individual, sikurse një ndërmarrje apo entitet tjetër biznesor, nuk mund ta deklarojë pronën si të përjashtuar (Kevin M. Lewis, 2018).

Moratoriumi Automatik

Aplikimi për falimentim i mundëson debitorit disa përfitime të menjëhershme. Ndoshta më e rëndësishmja, “paraqitja e një kërkesë për falimentim mbetet fillimi ose vazhdimi i të gjitha procedurave gjyqësore jo-falimentuese kundër debitorit” përjashton kreditorët nga ndërmarrja e ndonjë veprimi për të mbledhur, vlerësuar ose rimarrë një kërkesë kundër debitorit që u ngrit para fillimit të rastit; dhe, me përjashtime të caktuara, ndalon kreditorët nga ndërmarrja e pothuajse çdo veprimi kundër debitorit ose pronës së pasurisë. Këto mbrojtje njihen së bashku si “qëndrimi automatik” ose zakonisht referohen si Moratorium në Jurisprudencën e Kosovës. Moratoriumi është “automatik” sepse “operon pa nevojën për ndërhyrje gjyqësore”⁹; shkaktohet pas paraqitjes së kërkesës për falimentim pavarësisht nëse palët e tjera për procedurat e mbetura janë në dijeni që një kërkesë është paraqitur. Moratoriumi përgjithësisht mbetet në fuqi për një periudhë fillestare prej 120 ditëve dhe mund të zgjatet deri në 365 ditë, apo më herët nëse Gjykata mbyllë rastin, e hedh poshtë rastin, apo i jep debitorit një lirim, cilado që vie e para.

Politika e cila përkufizon moratoriumin është që të mbrojë asetet e debitorit nga kaosi dhe shterimi i kotë i cili rezulton nga procedurat e shumëfishta, të pakoordinuara dhe potencialisht konfliktuozë gjyqësore dhe përmbartuese të cilat mund të ndodhin në mungesën e moratoriumit. Moratoriumi i siguron debitorit një frymëmarrje nga kreditorët duke parandaluar përpjekjet e përbashkëta dhe gjitha veprimet përvetësuese. Moratoriumi mbron kreditorët, gjithashtu, duke përjashtuar kreditorët të caktuar që veprojnë njëanshëm në interes të vetvetes për të marrë pagesa nga debitori në dëm të kreditorëve të tjerë (Kevin M. Lewis 2018).

Gjykata mund të jap lehtësim nga moratoriumi për arsye, siç mund të ekzistojë kur vështirësia për lëvizje e cila rezulton nga aplikimi i moratoriumit do të tejkalonte “vështirësinë e debitorit” nëse moratoriumi do të hiqej, apo kur debitori ka aplikuar për falimentin me besim të keq vetëm për të parandaluar një përvetësim të afërt. Ndryshe, gjykata gjithashtu mund të vendos lehtësim “sa i përket moratoriumi të një veprimi kundër pronës” nëse debitori nuk ka ekuitet në një pronë të tillë dhe një pronë e tillë nuk është e nevojshme për riorganizimin efektiv të debitorit. Neni 29 i Ligjit për Falimentimin parasheh që, sipas kërkesës së një pale me interes, gjykata mund të ndërpresë, ndryshoj, kushtëzoj, anulojë, apo amendoj moratoriumin nëse:

- Debitori dështon që ti ofrojë siguri për ruajtjen e vlerës kreditorit dhe kreditori dëshmon se kërkesa për ruajtje të vlerës së barrës së tij ishte e vlefshme dhe e arsyeshme; apo
- Kreditori dëshmon se vlera e siguruar me barrë e tejkalon vlerën e pronës ndaj të cilës kreditori ka barrën, dhe se:
 - Rasti është rast për likuidim; apo
 - Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese dështon ti vërtetojë gjykatës se prona ndaj të cilës ekziston barra është pronë e rëndësishme për realizimin efektiv të riorganizimit.

⁹ Neni 26, paragrafi. 1 i Ligjit për Falimentimi parasheh, ndër të tjera se “Përpos në rastet kur parashihet ndryshe në këtë ligj, një kërkesë e paraqitur për procedurë të falimentimit e iniciuar sipas Kapitullit III të këtij Ligji do të vendos moratorium dhe urdhër ndalese, pa paralajmërim ...”

Financimi pas aplikimit te pasurisë falimentuese

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të merr kredi të pasiguruar dhe të shkaktoj **borxh të pasiguruar** gjatë rrjedhës normale të biznesit të tij, i cili lejohet si një shpenzim administrativ, me autorizimin e Gjykatës.

Nëse përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk mund të merr kredi të pasiguruar të pranueshme si një shpenzim administrativ, gjykata mund të autorizojë marrjen e kredisë apo borxhin e shkaktuar si shpenzim administrativ:

- Me prioritet mbi ndonjë apo gjitha shpenzimet administrative;
- Siguruar nga një barrë mbi pronën e pasurisë falimentuese e cila nuk është ndryshe subjekt i ndonjë barre; apo
- Siguruar nga një barrë mbi pronën e cila është pjesë e pasurisë falimentuese e cila është siguruar më herët nga një barrë, me kusht që barra e re nuk ka përparësi ndaj barrës ekzistuese.

Autorizimi i Gjykatës për financimin e asetëve nga kredia në asnjë rast nuk do të deklarohet i pavlefshëm apo i pazbatueshëm nga kreditorët apo nga trupi përfaqësues i kreditorëve.

Kontratat dhe obligimet ende me detyrim të përmbushjes nga dy palët

Procedura e falimentimit mund ta gjejë debitorin me detyrime të caktuara të cilat janë suspenduar apo të cilat kanë afat të përmbushjes. Kjo mund natyrshëm të shtojë obligime shtesë ndaj debitorit. Debitori i cili është në procedura të falimentimit detyrohet sipas këtij Ligji që të bashkëpunojë plotësisht me administratorin dhe ti sigurojë atij/asaj qasje të plotë në gjithë dokumentacionin dhe informatat e aktivitetëve dhe burimeve të debitorit. Për më tepër, ky informacion duhet të përfshijë gjitha informatat sa i përket shpenzimeve, transfereve, shitjen e asetëve të bëra brenda një viti para datës së paraqitjes së kërkesës për falimentim dhe gjitha pagesat, transferet apo transaksionet afariste të bëra me anëtarët e menaxhmentit të debitorit, trupit menaxhues, anëtarët e familjes apo punëtorët e brendshëm.

Kontratat e pa përmbushura: Disa nga këto informacione të siguruar për administratorin mund të përmbajnë kontrata në mes të debitorit dhe palëve të treta, të cilat nuk janë përmbushur nga asnjëra palë. Nëse ky është rasti, atëherë administratori ka autoritetin që të pranojë apo të refuzojë kontratat e tilla.

Kjo lidhet me çdo kontratë e cila ka afat kohor të përmbushet në të ardhmen, të cilën nuk kanë filluar ta përmbushin as debitori dhe as pala e tretë. Administratori ka autoritetin e tij apo të saj që të pranojë apo të refuzojë tërësisht kontratën. Megjithatë, në momentin kur një kontratë e tillë është përmbushur nga ndonjëra prej palëve, atëherë këto dispozita janë të pazbatueshme dhe administratori nuk ka autoritetin të pranojë apo të refuzojë.

Në përputhje me Ligjin, kontratat e pa përmbushura janë ato kontrata të debitorit të cilat, në kohën e hapjes së rastit, nuk janë përmbushur nga debitori apo pala debitore dhe se mos përmbushja nga asnjëra prej palëve do të përbënte shkelje sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë.

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese do të **pranojë, refuzojë apo caktojë** një kontratë të pa përmbushur me aprovim të gjykatës mbi vendimin e tij për të pranuar, refuzuar apo caktuar ndonjë kontratë të pa përmbushur. Gjykata gjithashtu do të aprovojë vendimin e përfaqësuesit të pasurisë falimentuese nëse përfaqësuesi i pasurisë falimentuese dëshmon tek gjykata se ky vendim është bërë në ushtrim të funksionit të tij me **mirëbesim** dhe me **grykim të shëndoshë afarist**, dhe se gjitha kërkesat e tjera të këtij Ligji janë përmbushur.

- Nëse përfaqësuesi i pasurisë falimentuese pranon një kontratë të pa përmbushur, pasuria falimentuese bëhet përgjegjëse për gjitha detyrimet e përmbushjes sipas kontratës, dhe çdo detyrim i cili mund të lind si rezultat i një kontrate të tillë do të konsiderohet si shpenzim administrativ;
- Nëse përfaqësuesi i pasurisë falimentuese refuzon apo cakton një kontratë të pa përmbushur, pasuria falimentuese nuk është më përgjegjëse për asnjë detyrim të ardhshëm të përmbushjes sipas kontratës, dhe çdo përgjegjësi sipas kon-

tratës do të trajtohet sikurse ka lind menjëherë para hapjes së procedurave të falimentimit. Refuzimi konsiderohet të jetë vetëm një shkelje e kontratës së pa përmbushur; nuk e shfuqizon ose e zhvlerëson ndonjë tjetër.

Korniza Kohore: Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese do të përcaktohet për të pranuar apo refuzuar një kontratë të pa përmbushur në kohën më të hershme pas konfirmimit të planit të riorganizimit deri në afatin e fundit kohor e cila është koha para mbylljes së rastit.

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të marrë një kontratë të pa përmbushur për të cilën debitori ishte *në mos përmbushje* vetëm nëse:

- Përfaqësuesi plotëson mos përmbushjen duke zbatuar detyrimin;
- Kompenson palën jo debitore për secilin dëm i cili është shkaktuar për të shkak të mos përmbushjes së tillë; dhe
- Siguron dëshmi të sigurimit adekuat të përmbushjes së obligimit gjatë përmbushjes së kontratës në të ardhmen.

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk mund të marrë kontratën nëse:

- Kontrata ishte obligim apo premtim për të marrë një kredi apo ndonjë instrument tjetër financiar;
- Një ligj i zbatueshëm lejon palën jo debitore që të mos pranojë përmbushjen e kontratës nga një entitet tjetër përveç debitorit, dhe pala jo debitore nuk pajtohet me marrjen e detyrimit për përmbushje.

Arsyeshmëria: Përfaqësuesit të pasurisë falimentuese nuk i kërkohet që të përmbush ndonjë detyrim të pa përmbushur sipas kontratës së refuzuar, dhe pala jo debitore do të mbajë përgjegjësi për kompensimin e çdo dëmi i cili mund të ndodh për shkak të refuzimit të tij për të përmbushur detyrimet sipas kontratës.

Braktisja e pasurive rënduese për pasurinë falimentuese

Sipas kërkesës së përfaqësuesit të pasurisë falimentuese, gjykata mund të lejojë përfaqësuesin që të braktisë, për çdo palë me interes, çdo pronë *e cila rëndon pasurinë e falimentmit*. Sipas kërkesës së palës në interes, gjykata do të urdhërojë përfaqësuesin e pasurisë falimentuese që të braktisë çdo pronë rënduese për pasurinë falimentuese.

Përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe, çdo pronë e caktuar nga debitori dhe e cila nuk administrohet ndryshe në kohën e mbylljes së rastit i lihet debitorit.

Kapitulli V.

Kërkesat, Procedurat e Kërkesave në Riorganizim dhe Likuidim

Kërkesat bëhen nga Kreditorët për ti kërkuar Debitorit që ai të paguajë gjitha apo një pjesë të borxhit të cilin ai i detyrohet. Në fakt, sapo Debitori të shkon në falimentim, mënyra e vetme për kreditorin që të kërkojë ndonjë pagesë të borxhit të cilën debitori i detyrohet atij/asaj është që të paraqes një kërkesë në përputhje me Ligjin për Falimentimin. Hapja e rastit përshpejton maturitetin e gjitha kërkesave të pamaturuara (pa arritura) deri në datën e hapjes së rastit¹⁰.

A. Paraqitja e Kërkesës

Në Procedurë të Likuidimit, gjithë kreditorët duhet të paraqesin dëshmi të kërkesës¹¹ brenda 60 ditëve nga data e njoftimit për hapjen e rastit¹².

Në procedurë riorganizimi, përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe sipas nevojës së riorganizimit, kreditori duhet të dorëzojë dëshmi të kërkesës brenda 30 ditëve nga data e njoftimit për hapjen e procedurave të falimentimit¹³.

Regjistri i kërkesave do të jetë i hapur për publikun gjatë orëve të rregullta të punës së gjykatës, dhe gjykata do të lejojë për procedura të arsyeshme për inspektimin dhe kopjimin e të dhënave të tilla nga publiku.

Llogaritja e Kërkesës

Kërkesat e pamaturuara (pa arritura) do të konsiderohen të maturuara (arritura) në pikën kur gjykata vendos të hap rastin e falimentimit. Kërkesa kalkulohet si në vijim:

Kërkesa = Borxhi Kryesor + Interesi i Maturuar¹⁴.

***Shembull:** Andi LLC ka aplikuar për falimentim më 10 mars 2019 dhe ndër të tjera i detyrohet DanBank Sh.A. shumën prej 15,000 €. Interesi i përlllogaritur i principalit (borxhit kryesor) deri në paraqitjen e kërkesës është 1,300 €, i maturuar që nga hapja e rastit. Prandaj, DanBank Sh.A. llogarit kërkesën si më poshtë:*

$$\text{Kërkesa} = € 15,000 + € 1,300 = € 16,300$$

Meqenëse Ligji për Procedurën Kontestimore është i aplikueshëm deri më tani, nuk është në kundërshtim me Ligjin për Fal-

¹⁰ Neni 46 i Ligjit për Falimentimin.

¹¹ Shih Shtojcën 8 Forma për Depozitimin e Kërkesës.

¹² Neni 49.3 i Ligjit për Falimentimin.

¹³ Neni 49.4 i Ligjit për Falimentimin.

¹⁴ Neni 50.4 i Ligjit për Falimentimin.

imentimin¹⁵, pala gjithashtu mund të kërkojë tarifa të avokatëve bazuar në Skemën e Tarifave të aplikuar nga Shoqata e Avokatëve të Kosovës. Kështu, në një kërkesë tipike të € 16,300, Kreditori gjithashtu mund të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve të avokatëve me rreth € 500.00.

Interesi dhe Maturiteti

Kërkesat e pamaturuara (pa arritura) do të konsiderohen të maturuara (arritura) në pikën kur gjykata vendos të hap rastin e falimentimit.

***Shembull:** Andi LLC paraqiti kërkesën për falimentim me 10 Mars 2019 dhe ndër të tjera i detyrohet DanBan Sh.A. shumën prej 15,000 € për borxhin i cili maturohet më 11 Dhjetor 2019. Pas paraqitjes së kërkesës për falimentim me 10 Mars 2019, borxhi ndaj DanBank Sh.A. maturohet automatikisht pa marrë parasysh faktin që duhet të ishte maturuar më 11 dhjetor 2009*

Llojet e Kërkesave

Ekzistojnë dy lloje të kërkesave:

- **Kërkesat e siguruar:** Këto janë kërkesa ku borxhi është siguruar nga koletarali.
- **Kërkesat e pasiguruar:** Këto janë kërkesa ku borxhi nuk është siguruar nga ndonjë kolateral. Për më tepër, nëse të hyrat e gjeneruara apo të cilat parashihen të gjenerohen nga shitja apo transferimi i pronës së siguruar është i pamjaftueshëm që plotësisht të përmbush kërkesat relevante të siguruar, pjesa e cila parashihet të mbetet e pa përmbushur konsiderohet se është kërkesë e pasiguruar. Shih pjesën D të këtij Kapitulli për të kuptuar prioritetin brenda kërkesave të pasiguruar.

B. Kundërshtimi i kërkesës dhe verifikimi

Secili kreditor duhet të paraqes një kërkesë dhe dëshmi të kërkesës për të vërtetuar gjykata vlefshmërinë dhe shumën e kërkesës së tij. Ligji parashih që gjykata do të sigurojë palët me një formë specifike të regjistrimit të kërkesës dhe dëshmi për ekzistencën e kërkesës. Në mungesë të ndonjë forme specifike, kreditorët do të paraqesin në gjykatë një deklaratë me shkrim e cila konsiderohet si deklaratë nën betim:

- E cila përshkruan kërkesë, përfshirë nëse është kërkesë e siguruar, me prioritet apo e pasiguruar;
- E cila vendos shumën e kërkesës që nga data e hapjes së rastit të falimentimit;
- E cila ka të bashkangjitura kopje të sakta dhe të plota të dokumenteve të cilat lidhen me kërkesën apo me ndonjë siguri e cila lidhet me kërkesën e tillë, nëse aplikohet.

Dëshmia e kërkesës e paraqitur në përputhje me këtë ligj do të përbëjë dëshmi të supozuar të vlefshmërisë dhe shumës së kërkesës së kreditorit, dhe çdo siguri për atë kërkesë. Nëse nuk ka asnjë kundërshtim me kërkesën, kreditorët nuk duhet të marrin ndonjë veprim të mëtejshëm dhe kërkesa do të konsiderohet si e pranuar.

Një palë me interes mund të kundërshtojë dëshminë e kërkesës. Nëse një palë me interes kundërshton dëshminë e kërkesës, gjykata do të përcaktojë vlefshmërinë dhe shumën e kërkesës në euro sipas Ligjeve të aplikueshme, që nga data e hapjes së rastit të falimentimit. Pala kundërshtuese do të sigurojë dëshmi për kundërshtimin e saj. Përpos nëse nuk kërkohet ndryshe nga pala

¹⁵ Neni 9 i Ligjit për Falimentimin.

e cila kundërshton kërkesën apo përpos nëse urdhërohet nga gjykata, supozimi i vlefshmërisë së dëshmisë së kërkesës vazhdon deri sa gjykata të marrë një aktvendim për të kundërtën.

Gjykata do të vlerësojë për qëllimin e lejimit:

- çdo kërkesë të kushtëzuar apo pakualifikuar, fiksimi apo likuidimi i së cilës, sipas rastit, do të vononte padrejtësisht administrimin e rastit; apo
- vlera e çdo të drejte të përmbushjes që buron nga e drejta për një mjet juridik për shkeljen e përmbushjes.

Gjykata nuk do të lejojë asnjë kërkesë për rimbursim të ndonjë subjekti i cili është përgjegjës me debitorin apo ka siguruar kërkesën e një kreditori, deri në masën që:

- kërkesa e tilla e kreditorit kundër pronës falimentuese nuk lejohet;
- kërkesa e tillë për rimbursim kushtëzohet nga koha e lejimit apo mos lejimit të një kërkesë të tillë për rimbursim; apo
- një subjekti i tillë pretendon të drejtën e zëvendësimit ose caktimit në ligj të të drejtave të një kreditori të tillë.

C. Efektet e verifikimit

Në procedurë të likuidimit, jo më vonë se 10 ditë pas zgjidhjes së gjitha kundërshtimeve të kërkesës, Administratori do të hartojë dhe do të dorëzojë në gjykatë një listë përfundimtare të kërkesave, duke treguar shumën dhe statusin e tyre.

Administratori gjithashtu do të dorëzojë listën përfundimtare të kërkesave tek komiteti i kreditorëve, nëse një i tillë është themeluar. Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve që nga dita e dorëzimit të listës në gjykatë nuk bëhet asnjë ankesë, atëherë lista konsiderohet përfundimtare për të gjitha qëllimet.

Meqenëse plani i riorganizimit trajton gjitha kërkesat, plani i riorganizimit konsiderohet se përfshinë listën përfundimtare të kërkesave dhe përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk ka nevojë që të paraqesë ndonjë listë shtesë të kërkesave në procedurën e riorganizimit.

Kapitulli VI.

Blerja e Pasurive dhe Shmangia e Bartjes

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese do të ketë kompetencën që të shmangë bartjet e bëra, dhe të rikthejë pronën e bartur, para fillimit të procedurave të falimentimit. Shmangia nënkupton *mënjanimin* apo *anulimin e bartjeve të caktuara* ashtu që është jo efektive retroaktivisht dhe që transferuesi konsiderohet se nuk ka blerë ligjërisht asgjë nga debitori.

- Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese duhet të ketë kompetencë që të rikthejë me veprim, apo të kërkojë dhe pranojë qarkullimin e, çdo prone të pasurisë falimentuese e cila mbahet nga ndonjë subjekt tjetër nga debitori në momentin e fillimit të procedurës së falimentimit.
- Çdo subjekt në posedim apo kontroll të pronës së pasurisë falimentuese do të dorëzojë tek përfaqësuesi i pasurisë falimentuese pronën e tillë apo vlerën e pronës së tillë, dhe varësisht nga përfaqësuesi i pasurisë falimentuese i cili siguron mbrojtjen e vlerës.
- Ndonjë subjekt i cili ka borxh i cili është prone e pasurisë falimentuese dhe e cila është maturuar apo pagueshme, do të paguhet menjëherë pas kërkesës për një borxh të tillë në tërësi, tek përfaqësuesi i pasurisë falimentuese.

Bartjet preferenciale

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të *anulojë* bartjen nëse:

1. Bartja ka ndodhur para fillimit të procedurës së falimentimit;
2. Bartja i është bërë kreditorit ose është bërë për përfitim të kreditorit ku pagesa ka pasur efektin e zvogëlimit të ekspoizimit ndaj një garancioni për llogari të borxhit i cili është mbledhur para bartjes;
3. Bartja është bërë kur debitori ka qenë josolvent;
4. Bartja është bërë deri në njëqind e njëzet (120) ditë para fillimit të procedurës së falimentimit, ndërsa në rastet kur përfituesi i transferit është person i brendshëm, bartja është bërë deri treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë para fillimit të procedurës së falimentimit; dhe
5. Bartja i ka mundësuar përfituesit të transferit të pranojë më shumë nga debitori dhe pasuria falimentuese, se sa që do të kishte pranuar në rastet kur do të incohej procedura e likuidimit dhe ai do të kishte marrë dividendën e tij nga pasuria e likuiduar.

Bartja nuk kualifikohet për anulim nëse bartja i është bërë:

1. Një kreditori të siguar gjatë kohës kur vlera e kolateralit ka qenë më e madhe se shumica e kërkesës së siguar të kreditorit;
2. Një kreditori me kërkesë të siguar, kolaterali i të cilit ka vlerë më të vogël se të gjitha kërkesat e tij, por vetëm deri në masën që vlera e bartjes tejkalon vlerën e diferencës në mes të vlerës së të gjitha kërkesave të kreditorit dhe vlerës së kolateralit të kreditorit; dhe
3. Një kreditori me prioritet në pagesa ndaj kreditorëve të përgjithshëm të pasiguar deri në masën sa pasuria nuk është në situatë të pa aftësisë paguese për shpenzimet administrative.

Kreditori gëzon mbrojtje të plotë ndaj një veprimi për anulim të bartjes, mirëpo duhet të mbështetet me dëshmi, deri në masën që:

1. Bartja është bërë si rezultat i rrjedhës normale të biznesit të debitorit;
2. Bartja është barra, dhe barra është dhënë për ti mundësuar debitorit blerjen e pronës së ngarkuar me atë barrë; ose
3. Bartja është bërë si rezultat i urdhrat të gjykatës për pagesë të alimentacionit ose gjykata ka urdhëruar kompensimin e viktimave të dhunës.

Bartjet jo komerciale dhe për qëllime mashtrimi

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të anulojë një bartje apo një obligim të debitorit në rast se:

1. Bartja është bërë nga debitori me qëllim të fshehjes, pengimit ose mashtrimit të kreditorëve brenda 2 viteve nga iniciimi i procedurës së falimentimit;
2. Bartja është bërë me vlerë më të vogël se sa vlera e arsyeshme ekuivalente¹⁶ përderisa debitori ishte insolvent; apo kishte kapital apo rezerva të pamjaftueshme për të paguar në mënyrë të arsyeshme detyrimet e tij të pritshme; dhe është bërë brenda 2 viteve nga iniciimi i procedurës së falimentimit.

Përfituesi i bartjes ose përfituesi i pagesës së një detyrimi që pranon një vlerë dhe që ka një barrë në mirëbesim mund të ruajë një interes të bartur ose mund të përmbarojë çfarëdo obligimi të mbledhur, deri në masën që një bartje ose pagesë e tillë i jep vlerë debitorit në shkëmbim për bartjen ose detyrimin.

Bartjet e paautorizuara pas paraqitjes së kërkesës për falimentim

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese **mund** të anulojë një bartje të pronës së pasurisë falimentuese:

1. E cila ka ndodhur pas iniciimit të procedurës së falimentimit; dhe
2. E cila nuk është e lejuar sipas këtij ligji apo nga gjykata.

Në rastet e iniciimit të procedurës së falimentimit nga kreditorët, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese **mund të** anulojë një bartje e cila ka ndodhur pas iniciimit të procedurës së falimentimit mirëpo para hapjes së rastit, përderisa përfituesi i bartjes ka dhënë një vlerë në shkëmbim të bartjes së tillë.

Kërkesat e siguruarat të papërshtatshme

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të anulojë një barrë nëse një ligj i aplikueshëm kërkon regjistrimin e një barre në regjistra publik dhe nëse kreditori deri në momentin e iniciimit të procedurës së falimentimit nuk e ka kryer obligimin ligjor të regjistrimit të barrës së tillë në regjistra publik.

Pasojat e anulimit të bartjes

Përderisa një bartje është anuluar, përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit **mund të rikthejë pronën** e transferuar për të mirën e pasurisë falimentuese, apo vlerën e asaj prone nëse urdhëron gjykata, nga:


- përfituesi fillestar i bartjes së tillë apo nga entiteti i cili ka përfituar nga bartja e tillë; ose
- cilitdo përfitues i asaj bartje fillestare, ose kushdo i cili është përfitues titullar i asaj prone apo rezulton nga bartja nga përfituesi fillestar.

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese **nuk mund të rikthejë** pronën nga:

- përfituesi i bartjes i cili e ka pranuar vlerën, përfshirë përmbushjen apo sigurimin e një borxhi të tashëm apo të ardhshëm, në mirëbesim, pa pasur njohuri se një bartje e tillë do të mund të anulohet;
- cilitdo përfitues i bartjes nga përfituesi paraprak i bartjes i cili ka vepruar me mirëbesim.

¹⁶ "Vlera" nënkupton pasurinë, ose përbushjen ose sigurimin e një borxhi të tanishëm ose paraardhës të debitorit, por nuk përfshin një premtim të paralelizuar për t'i dhënë mbështetje debitorit ose një të afërmi të ngushtë të debitorit;

Një përfitues i bartjes me mirëbesim prej të cilit përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të rikthejë pronën ka një barrë mbi pronën e rikthyer për të siguruar koston për përmirësimet e bëra pas bartjes ndaj përfituesit të bartjes, më pak se shumica e ndonjë përfitimi të realizuar nga përfituesi i bartjes prej asaj prone; dhe çfarëdo rritje të vlerës të asaj prone si rezultat i përmirësimeve të bëra, të pronës së bartur.



Kapitulli VII.

Riorganizimi.

Përderisa qëllimi i Kapitullit VII të Ligjit për Falimentimin i cili rregullon Procedurat e Likuidimit është të likuiojë datën e debitorit, shumica e Kapitullit VI i Ligjit për Falimentimin, përkatësisht Kapitulli për Procedurat e Riorganizimit kanë për qëllim që të riorganizojë strukturën e borxhit të debitorit në atë mënyrë që debitori të mund të vazhdojë të funksionojë. Kapitulli VI për Riorganizimin është paraparë mbi konceptin që debitori ka gjasë të vlejë më shumë në cilësinë e problemit të vazhdueshëm se sa në likuidim. Kjo do të thotë, se vazhdimi i biznesi të debitorit me gjasë do të krijojë më tepër vlerë se sa do të krijonte shitja e copëzuar e aseteve. Këto parime për riorganizim janë përcaktuar në Nenin 4, paragrafi 3 i Ligjit për Falimentimin.

Në këtë mënyrë, debitori i cili ka për qëllim që të dal nga falimentimi si një subjekt operativ në krahasim me mbylljen e dyerve të tij ka të ngjarë të preferojë Riorganizimin se sa Likuidimin. Disa kreditorë mund gjithashtu të preferojnë që debitori të riorganizojë se sa të likuiojë biznesin e tij, në varësi të faktit nëse ata do të nxjerrin një përfitim më të madh ekonomik nga debitori që vazhdon funksionimin si një problem i vazhdueshëm se sa nëse debitori likuiohet menjëherë.

Procedurat e Riorganizimit zakonisht përdoren nga debitorë e biznesit, sikurse korporatat dhe ndërmarrjet me përgjegjësi të kufizuar, pavarësisht madhësisë së tyre. Ekzistojnë procedura të përshpejtuara për NVM-të në bazë të Kapitullit II të Ligjit për Falimentimin të cilat në fakt parashikojnë përpjekje të obligueshme të riorganizimit për NVM-të para inicimit të procedurave të falimentimit. Që nga viti 2020, nuk ka shembuj të riorganizimit në Kosovë sipas Ligjit të ri për Falimentimin, megjithatë nëse shikoni shembuj të kompanive të mëdha jashtë vendit të cilat kanë paraqitur kërkesë për falimentim si riorganizim, ato përfshijnë korporata të mëdha sikurse General Motors (Chenault v. Gen. Motors LLC).

Bizneset individuale dhe partneritetet, sikurse korporatat, gjithashtu kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për lehtësim sipas Kapitullit të Riorganizimit të Ligjit për Falimentimin në Kosovë. Posaçërisht, një biznes individual i cili nuk ka të drejtë të aplikojë menjëherë për procedura të likuidimit sepse janë brenda kufijve të NVM-ve, ata mund të vend të kësaj të jenë në gjendje që të aplikojnë për riorganizim.

Qëllimi kryesor i Procedurave të Riorganizimit është formulimi i një plani gjithëpërfshirës të riorganizimit i cili rregullon të drejtat dhe detyrimet në mes të debitorit dhe kreditorëve të tij, në atë mënyrë që të kthejë debitorin e riorganizuar në një subjekt të shëndetshëm ekonomik. Plani i riorganizimit bëhet kontratë detyruese në mes të debitorit dhe kreditorëve të tij, dhe qeveris të drejtat dhe detyrimet e tyre.

A. Plani i Riorganizimit.

Siç është përmendur në Kapitullin I të këtij Manuali, qëllimi kryesor i Procedurës së Riorganizimit është që “të formulojë një plan gjithëpërfshirës të riorganizimit i cili përfundimisht do të rehabilitonte debitorin me shqetësime financiare. Idealisht, Plani i Riorganizimit është një produkt i negociatave në mes të debitorit dhe palëve të tij kyçe më interes i cili i rregullon të drejtat dhe detyrimet në mes të debitorit dhe kreditorëve të tij, në atë mënyrë që të kthejë debitorin e riorganizuar në një subjekt të shëndetshëm ekonomik (Kevin M. Lewis, 2018).

Debitori mund të paraqesë Planin e Riorganizimit në çdo kohë. Edhe pse një palë me interes për rastin e falimentimit, sikurse kreditori, mund potencialisht të propozojë një Plan të vetin të Riorganizimit, Ligji për Falimentimin kufizon aftësinë e jo debitorit për të propozuar një plan të riorganizimit në disa aspekte. Për të dhënë një shembull, Ligji për Falimentimin përcakton një periudhë fillestare të ekskluzivitetit gjatë së cilës “vetëm debitori mund të paraqesë një plan”.

Ndër kërkesat e tjera, plani i propozuar duhet

- klasat e kërkesave ose bartësve të kapitalit të cilët nuk preken nga plani;
- propozimin për trajtimin e secilës klasë të kërkesave të cilat preken nga plani;
- propozimin e debitorit për emërimin dhe kompensimin e menaxhmentit të tij;
- çdo ndryshim në dokumentet themeluese të debitorit, nëse plani konfirmohet;
- çdo dispozitë tjetër opcionale të parashikuar në Nenin 75 të Ligjit.

Pasi pala propozon planin, kreditorët të cilët afektohen negativisht nga plani mund pastaj të votojnë në favor apo kundër planit. Përgjithësisht, në mënyrë që të lehtësohet procesi i votimit, propozuesi i planit duhet gjithashtu të dorëzojë një deklaratë të heqjes së përgjegjësisë e cila i jep palës potencialisht të afektuar nga plani informata të mjaftueshme për ti mundësuar atyre që të bëjnë një gjykim të informuar sa i përket votimit të tyre në favor të planit. Gjykata pastaj do të “caktojë një kohë brenda së cilës” kreditorët mund të votojnë për planin. Kreditorët votues duhet të hedhin votën e tyre për planin. Detajet e votimit dhe pranimit të planit të riorganizimit janë elaboruar më detajisht në këtë Kapitull. (Kevin M. Lewis, 2018)

Përpos kësaj, për tu konfirmuar, secili plani i riorganizimit duhet të jetë i *realizueshëm*¹⁷. Kjo nënkupton se propozuesi i planit, në përputhje me parimet e riorganizimit të Ligjit për Falimentimin, duhet të tregoj se “konfirmimi i planit nuk ka të ngjarë të pasohet nga likuidimi, apo nevoja për riorganizim të mëtejshëm financiar, të debitorit, përpos nëse likuidimi apo riorganizimi i tillë propozohet në plan. Qëllimi i kësaj kërkesë për realizueshmëri është që të parandalojë konfirmimin e planeve jo reale të cilat i premtojnë kreditorëve dhe mbajtësve të asetëve të siguruara më tepër se sa debitori mund me gjasë të arrijë të bëjë pas konfirmimit të planit. Një plan është i përzemësueshëm, për shembull, nëse i propozon ti “mbajë kreditorët” në pritje” pa pranimin e pagesave përdërisa debitori kërkon të shes pasurinë e patundshme e cila nuk ka arritur të shitet në vitet e fundit, dhe kështu planet nuk janë asgjë më shumë se sa ndërmarje spekulative të cilat vendosin gjithë rrezikun mbi kreditorët. Është gjithashtu e rëndësishme të merret parasysh se bazuar në parimet e Ligjit për Falimentimin sa i përket riorganizimit, Planin e Riorganizimit mund të mos konfirmohet nëse nuk i përmbush *interesat më të mira të kreditorëve*¹⁸. Kjo kërkon që secili mbajtës i një kërkesë të dëmtuar apo interes të dëmtuar ose të pranojë planin ose të pranojë sipas planit jo më pak se sa do të pranonte në likuidim. Kjo nënkupton se, në mungesë të pëlqimit, kreditori duhet të pranojë pronën e cila ka një vlerë aktuale të barabartë me shpërndarjen hipotetike të likuidimit të atij pjesëmarrësi nëse debitori do të likuidohej në vend të riorganizohet në datën efektive të planit. Si rezultat, sepse të kesh, për shembull, një EURO në dorë ditë e sotme është më tepër e vlefshme se sa e njëjta EURO do të pranohej disa vite më parë, Planin e Riorganizimit nuk përmbush testin e interesave më të mira të kreditorëve nëse debitori, në vend që ti paguante kreditorëve shumën që ata do ta pranonin në Procedurë të Likuidimit në plotësi në ditën efektive të planit, propozon në vend të kësaj të paguajë të njëjtën shumë me kalimin e kohës. Ku, përkundrazi, kreditorët e dëmtuar nuk do të pranonin asgjë në Likuidimin hipotetik, plani me gjasë do të përmbushte testin e interesave më të mira të kreditorëve sepse Planin e Riorganizimit matematikisht nuk mund ti paguajë kreditorët më pak se zero (Kevin M. Lewis, 2018).

17 Fizibiliteti edhe pse nuk përcaktohet në përkufizimet e ligjit, ai përmendet në disa raste në lidhje me konfirmimin e planit. Shihni për shembull, Nenin 14, paragraf 1, nën-paragraf 1.2 dhe 1.4; Neni 13, paragraf 5 dhe 6 të Ligjit për Falimentimin

18 Shih dispozitat në lidhje me dëmtimin e kërkesës në Nenin 73 të Ligjit për Falimentimin.

B. Përmbajtja e planit të riorganizimit.

Një mostër e Planit të Riorganizimit është përgatitur dhe është bashkangjitur si Shtojcë e këtij Manuali për Administratorët e Falimentimit. Përgatitja dhe dorëzimi i Planit të Riorganizimit mund të jetë një proces shumë i kushtueshëm. Varësisht nga madhësia e organizatës biznesore, ky proces mund të kërkojë punë intensive nga shumë profesionistë (avokatë, ekonomistë, kontabilistë). Plani është një dokument mjaft i detajuar, i cili përfshin një pasuri të informacioneve sa i përket rikthimit të një organizate biznesore me gjendje të vështirë dhe është tepër specifike për secilin rast. Përgjithësisht, bazuar në kërkesat e Ligjit për Falimentimin, ekzistojnë disa dispozita të detyrueshme të cilat duhet të përfshihen në Planin e Riorganizimit dhe Dispozita të tjera Operacionale të cilët mund të përfshihen në baza të rastit.

Është **obligative** që Plani i Riorganizimit të specifikojë:

1. klasat e kërkesave apo bartësit e ekuitetit të cilët nuk preken nga plani;
2. propozimin për trajtimin e secilës klasë të kërkesave të cilat preken nga plani;
3. propozimin e debitorit për emërimin e menaxhmentit të tij dhe propozimin për shpërblimin që do ti paguhet atij menaxhmenti; dhe
4. ndryshimet e nevojshme në aktet themeltare të debitorit, nëse plani konfirmohet.

Dispozitat **fakultative** të Planit të Riorganizimit mund të përfshijnë:

1. prekin ose ti lënë të paprekura klasat e kërkesave, të siguruar ose të pasiguruara, apo të bartësve të ekuitetit;
2. ofrojë supozime për pranimin, refuzimin ose transferimin e një kontrate të pa përmbyshur;
3. ofrojë trajtimin si vijon për kërkesat të mbajtura nga debitorit:
 - a. zgjidhjen ose përshtatjen e çfarëdo kërkesë ose interesi që i takon debitorit ose pasurisë falimentuese;
 - b. përbarimin e kërkesës së tillë ose interesit nga përfaqësuesi i pasurisë falimentuese;
4. ofrojë mundësinë e shtijës së të gjitha pronave të pasurisë falimentuese dhe shpërndarjen e mjeteve të grumbulluara nga shitjet të kreditorët dhe bartësit e ekuitetit;
5. modifikojë të drejtat e mbajtësve të kërkesave të siguruar, apo të mbajtësve të kërkesave të pasiguruara, apo ti lejë të paprekur të drejtat e mbajtësve të cilësdo klasë të kërkesave; dhe
6. përfshirë çfarëdo dispozite të rëndësishme që nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit.

Gjitha planet e riorganizimit duhet të përcaktojnë masa adekuate për implementimin e tyre me qëllim që debitori të mos kërkojë lehtësira financiare shtesë pas konfirmimit të planit. Masat adekuate të implementimit përfshijnë, mirëpo nuk kufizohen vetëm tek njëra apo më tepër pikat në vijim:

- mbajtjen nga debitori të një pjesë ose të gjithë pronën e pasurisë falimentuese;
- transferimin e një pjesë ose të të gjithë pronës së pasurisë falimentuese tek një apo më shumë entitete, të themeluara para apo pas konfirmimit të planit të tillë;
- bashkimin e debitorit me një apo më shumë persona;
- shitjen e një pjesë apo gjithë pronës së pasurisë falimentuese, e cila është subjekt apo jo i një barre, apo shpërndarjen e gjithë apo ndonjë pjesë të pronës së pasurisë falimentuese të të gjithë personat të cilët kanë interes në atë pronë të pasurisë falimentuese;
- përmbyshjen apo ndryshimin e një barre;
- trajtimin ose heqjen dorë nga një shkelje e një detyrimi;
- zgjatjen e afatit të maturitetit, ndryshimin e normave të interesit, kushteve të tjera të instrumenteve financiare të kredive, instrumenteve tjera kreditore; ose
- ofrimin e instrumenteve financiare garantuese për entitetet me kërkesa për garancione.

Shpalosja

Plani i Riorganizimit duhet të përmbajë informata të mjaftueshme të cilat i lejojnë çdo kreditori të informohet mjaftueshëm dhe në mënyrë adekuate për zgjedhjen që ata do të bëjnë nëse ata votojnë pro apo kundër Planit të Riorganizimit. Është e rëndësishme të deklarohet se Ligji kërkon që *Plani i Riorganizimit të deklarohet në gjuhën e kuptueshme* kur dhe si këto kërkesa janë përmbushur¹⁹.

Shënim: Edhe pse termi “gjuhë e kuptueshme” nuk është përkufizuar, megjithatë ka të ngjarë që qëllimi i tij është që të shmangë zhargonin ekonomik dhe ligjor i cili do të hutonte kreditorët nëse kërkesat e tyre duhet të përmbushen dhe në cilën formë. Kjo gjithashtu do të thotë, se informata duhet të prezantohet në një mënyrë të qartë dhe logjike, dhe e cila është strukturuar në mënyrë adekuate për ti paraqitur kreditorëve (votuesve) të gjitha opsionet dhe rezultate e tyre rrjedhëse, për të lejuar një vendim më të lehtë votues.

Përmbajtja e Planit të Riorganizimit, përpos elementeve të përshkruara më sipër, mund të ketë pamjen si në vijim:

- **Prezantimi:** një përshkrim i shkurtë i përgjithshëm i veprimtarisë afariste të debitorit dhe rrethanat të cilat kanë qar në vështirësi financiare;
- **Metodat dhe Mjetet:** përshkrimi i metodave dhe mjeteve për realizimin e planit, duke detajuar masat të cilat do të merren, me detaje të mjaftueshme se si plani do të implementohet, përfshirë secilin projekt financiar se ku është bazuar arritshmëria e planit;
- **Paratë e Gatshme Ekzistuese:** diskutim i shkurtë i shumës së parave të cilat me gjasë mund të jenë në dispozicion të kreditorëve, në të njëjtën mënyrë sikurse ndërmarrja e debitorit do të likuidohej se sa të riorganizohej sikurse është propozuar në plan dhe një përshkrim se si do të shpërndaheshin këto para;
- **Përmbushja e Kërkesave:** një deklaratë se çfarë shume e parave apo prone është propozuar të bartet për përmbushjen e plotë apo të pjesshme të kërkesave sipas kategorisë së kreditorëve si dhe procedurat për ekzekutimin e kërkesave dhe kohëzgjatjen e pagesave të tilla;
- **Procedurat e Shitjes së Aseteve:** përshkrimin e procedurave që do të përdoren për shitjen e secilit aset, duke treguar cilat asete do të shiten, me apo pa zgjatje të pengut apo hipotekës, dhe përdorimin e parashikueshëm të fitimeve nga shitjet e tilla;
- **Periodha Kohore për Riorganizimin:** deklarimi i afateve kohore për implementimin e planit, dhe koha për implementimin e komponentëve kryesore të planit;
- **Menaxhimi dhe Kompensimi:** deklarimi se kush do të jetë menaxhenti dhe cili do të jetë kompensimi i tyre;
- **Ekspertët dhe Kompensimi:** deklarimi se për çfarë do të përdoren specialistët e punësuar dhe cili do të jetë kompensimi i tyre, dhe cili do të jetë kompensimi për administratorin; dhe
- **Data e Riorganizimit:** Data kur plani do të hyjë në fuqi.

Plani i Riorganizimit duhet të ndajë (grupojë) kreditorët në dy apo më tepër kategori, me kusht që kreditorët e së njëjtës kategori janë në esencë të të njëjtit lloj. Megjithatë, kërkesat e siguruara dhe të pasiguruara nuk mund të vendosen në të njëjtën kategori.

Duhet të theksohet se Plani i Riorganizimit nuk mund të ndryshojë përparësinë e dhënë kreditorëve dhe përmbushjen e kërkesave të tyre. Me fjalë të tjera, një borxh i kreditorit me përparësi të ulët nuk mund të paguhet para pagesës së borxhit të kreditorit me përparësi më të lartë.

Shembull: Joe SHPK shkon në falimentim dhe Plani i tij i Riorganizimit tregon se kërkesat mund të përmbushen pjesërisht. Ndër kreditorët e Joe LLC është edhe Lumi Sh.A., i cili i ka dhënë borxh të siguar Joe SHPK dhe

¹⁹ Shiko tutje Nenin 77 të Ligjit për Falimentimin për Procedurën e Shpalosjes së Plan Propozimin.

LamaBank, SH.A., të cilat i kanë dhënë borxh të pasiguruar Joe SHPK. Planit i Riorganizimit nuk mund të përcaktojë shlyerjen e borxhit ndaj LamaBank Sh.A. para se të shlyejë borxhin ndaj Lumi Sh.A., sepse Lumi Sh.A. ka kërkesë me përparësi më të lartë.

C. Shumica e kërkuar dhe votimi

Konsiderohet se një klasë ka pranuar planin e riorganizimit nëse kreditorët që mbajnë të paktën pesëdhjetë përqind (50%) të kërkesave brenda asaj klase e pranojnë planin e riorganizimit. Një klasë konsiderohet se e ka pranuar planin e riorganizimit *pa pasur* nevojë për votim nëse kërkesat ose interesat mbi ekuitet brenda asaj klase mbesin të paprekura nga plani²⁰. Në anën tjetër, një klasë konsiderohet se e ka refuzuar planin e riorganizimit pa pasur nevojë për votim nëse plani i eliminon kërkesat apo interesat mbi ekuitet të asaj klase.

Planit i riorganizimit mund të konfirmohet nga Gjykata nëse propozuesi i planit i dëshmon Gjykatës se plani është në përputhje me ligjin, propozuesi ka vepruar në mirëbesim, kreditorët e prekur apo mbajtësit e ekuitetit pranojnë të paktën aq sa do të kishin pranuar në rast të likuidimit dhe se mjetet për implementimin e planit janë adekuate. Kjo njihet si **Konfirmimi konsensual i planit**, ashtu siç parashihet në Nenin 79 të Ligjit për Falimentimin.

Në anën tjetër, plani i riorganizimit i cili nuk pranohet nga gjitha klasat mund ende të konfirmohet nga Gjykata nëse kërkesat për konfirmimin konsensual të planit janë përmbushur dhe nëse plani nuk parasheh pagesë të plotë për kreditorët (qoftë me para të gatshme, sigurimet apo pronat e tjera) dhe që rregullat për shpërndarjen me përparësi përmbushen sikurse parashihet në Ligj. Kjo njihet si **konfirmimi jo konsensual i planit** ashtu siç parashihet në Nenin 80 të Ligjit për Falimentimin.

D. Seanca dëgjimore për riorganizimin.

Seanca dëgjimore për riorganizimin është një mundësi për propozuesin e Planit të Riorganizimit dhe palët me interes që të takohen dhe të adresojnë Planin e Riorganizimit. Përpos kësaj, Gjykata cakton këtë seancë dëgjimore në mënyrë që kreditorët të mund të votojnë nëse ata aprovojnë Planin e Riorganizimit. Është në diskrecionin e Gjykatës që të vendos një seancë dëgjimore pas dorëzimit të Planit të Riorganizimit.

E. Pasojat juridike të konfirmimit të planit

Një Plan i konfirmuar i Riorganizimit është i detyrueshëm për debitorin, kreditorët (përfshirë kreditorët të cilët nuk kanë votuar në favor të planit) dhe palët e tjera. Përveç nëse parashihet ndryshe në plan apo në vendimin e konfirmimit të planit, të gjitha pronat e pasurisë falimentuese i takojnë debitorit (Debitorit në Posedim). Përpos kësaj, konfirmimi i Planit të Riorganizimit përgjithësisht liron debitorin nga borxhi i tij i para konfirmuar dhe zëvendëson detyrimet e planit për borxhet e mëparshme të debitorit. Ky lirim funksionin si një urdhër i cili, me disa përjashtime, ndalon kreditorët nga mbledhja, rimarrja apo kompensimi i çfarëdo borxhi i cili ishte subjekt i liritimit (shih shpjegimet e mëtejshme në Moratoriumin). (Kevin M. Lewis, 2018)

²⁰ Faqja 36 e këtij Manuali shpjegon përkufizimin e Interesit më të mirë të Kreditorëve dhe dëmtimin e kërkesës.

Plani i konfirmuar në fakt krijon një kontratë të re në mes të debitorit dhe palëve me interes e cila zëvendëson gjitha detyrimet para kërkesës me një detyrim të ri kontraktual në përputhje me trajtimin e kreditorit sipas planit të konfirmuar. Kështu, kur një debitor dështon të paguajë apo të veprojë në përputhje me planin e konfirmuar, mjetet juridike të kreditorit parashihen në ligj, dhe përfshijnë kërkesat për kthimin e rastit të riorganizimit në një rast të likuidimit (Kevin M. Lewis, 2018).

F. Mjetet juridike në rast të dështimit të përmbushjes së Planit të Riorganizimit

Kërkesa për revokim të konfirmimit të planit mund të paraqitet nga një palë e interesuar në Gjykatë, nëse pala e interesuar:

- mund të dëshmojë se propozuesi i planit ka mashtruar për marrjen e votave për konfirmimin e planit; dhe
- një kërkesë e tillë paraqitet brenda gjashtë (6) muajve pas konfirmimit të planit.

Nëse debitori në riorganizim apo pala tjetër nuk vepron në përputhje me dispozitat e planit të konfirmuar të riorganizimit, pala me interes:

- mund ti paraqesë kërkesë gjykatës për detyrim të palës për të vepruar në përputhje me planin e riorganizimit dhe të kërkojë nga gjykata kompensimin e dëmit sikurse plani i riorganizimit të jetë një kontratë sipas dispozitave të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore;
- mund ti paraqesë kërkesë gjykatës për të anuluar pjesën e planit të pa realizuar, të tërheq lirimin që i është dhënë debitorit, dhe kërkojë nga gjykata të kthejë rastin në rast të likuidimit;
- mund ti paraqesë kërkesë gjykatës për të anuluar pjesën e planit të porealizuar, të tërheq lirimin e debitorit dhe ta pushon rastin.

Shndërrimi në likuidim: Gjykata nxjerr aktvendim për shndërrimin e riorganizimit në likuidim nëse pala e interesuar i dëshmon gjykatës se:

- është duke u shkaktuar humbje substanciale apo e vazhdueshme e pasurisë falimentuese dhe nuk ka ndonjë indikacion se situata do të përmirësohet;
- është duke u keq menaxhuar me përmasa të mëdha pasuria falimentuese;
- ka kaluar më shumë se 1 vit nga hapja e rastit, përveç nëse gjykata e sheh të arsyeshme të shtyjë afatin, shtyrje e cila nuk mund të kalojë tetëmbëdhjetë (18) muaj nga dita e hapjes së rastit;
- debitori në posedim ka dështuar të mirëmbajë një policë të sigurimit të përshtatshme dhe si rezultat paraqet rrezik për pasurinë falimentuese apo për publikun;
- debitori në posedim ka dështuar që të përmbush vendimin apo aktvendimin e gjykatës;
- debitori në posedim ka dështuar që të paguajë me kohë detyrimet tatimore, detyrime këto të krijuara pas akordimit të lirimit ndaj debitorit; ose
- debitori në posedim ka dështuar që të dorëzojë deklaratën mbi shpalosjet, planin e riorganizimit dhe kërkesën për konfirmimin e planit, brenda afateve kohore të caktuara nga gjykata.

G. Mbyllja e Rastit të Riorganizimit

Gjykata me aktvendim vendos për mbylljen e rastit të riorganizimit kur të gjitha obligimet e dala nga plani i riorganizimit janë përmbushur apo ekzekutuar.

Kapitulli VIII:

Procedura e Likuidimit

Bazuar në Ligjin e vjetër të Falimentimit në Kosovë (të vitit 2003), procedura e likuidimit ishte forma kryesore e falimentimit. Qëllimi kryesor i Procedurave të Likuidimit sipas Ligjit të ri për Falimentimin është që të likuideojë asetet e debitorit për të përmbushur kërkesat e kreditorëve të debitorit. Për të lehtësuar likuidimin, rasti administrohet nga një Administrator i Falimentimit i cili, ndër përgjegjësitë e tjera, ka detyrat e përgjithshme që të marr gjithë pronën në dispozicion, të i zvogëlojë atë në para, të i shpërndajë ato tek kreditorët, dhe të mbyllë pasurinë. Administratori merr kontrollin e subjektit me qëllim të realizimit të vlerës maksimale e cila është në dispozicion për përfitimin e kreditorëve.

Ligji për Falimentimit parasheh një hierarki komplekse të shpenzimeve dhe kërkesave të cilat kanë të drejtë të paguhet para tjerave. Për shembull, një “kreditor i siguar” – i cili është, një kreditor i cili ka të drejtë ligjore kundrejt një prone të caktuar (njohur edhe si “kolateral”) të cilën debitori e ka vënë peng si siguri kundrejt borxhit në rast se debitori bën shkelje ligjore – ka të drejtë që të paguhet plotësisht jashtë procedurave të kolateralit para se ndonjë prej këtyre të ardhurave të mund të përdoret për të paguar ndonjë “kreditorë të pasiguar” i cili, me dhënien e kredisë për debitorin, nuk merr asnjë të drejtë kundrejt pronës specifike të debitorit. Për të dhënë një shembull tjetër, kërkesat për lloje specifike të detyrimeve të brendshme të mbështetjes kanë të drejtë të paguhet para taksave të papaguara të pronave të caktuara. (Kevin M. Lewis, 2018)

Kreditorët me përparësi të ulët nuk mund të pranojnë asnjë pagesë deri sa kreditorët me përparësi të lartë të paguhet plotësisht. Nëse, për shkak të mungesës së asetëve në pasurinë, një nivel i përparësisë nuk mund të paguhet plotësisht, atëherë shpërndarja bëhet proporcionalisht në mes të kreditorëve me nivel të tillë. Nëse, në të kundërtën, pasuria ka asetë të mjaftueshme për të paguar plotësisht kërkesat e gjitha përparësive, shpërndarja do të bëhet proporcionalisht në mes të kreditorëve me përparësi të ulët. (Kevin M. Lewis, 2018)

A. Emërimi detyruar i një Administratori

Pasi rasti i likuidimit të jetë paraqitur, apo pasi rasti i riorganizimit të konvertohet në një rast të likuidimit, një Administrator emërohet në cilësinë e përfaqësuesit të pasurisë falimentuese të debitorit, e cila përgjithësisht përfshinë gjitha interesat pronësore të debitorit në datën e depozitimit. Administratori zgjidhet nga lista e Administratorëve e cila mirëmbahet nga Ministria e Drejtësisë. Në procedurë të likuidimit, Administratori, përpos që mban mbledhje me kreditorët, ai/ajo do të mbledhë çdo pronë jo përjashtuese e cila mund të shitet, të trajtojë çdo shitje, shpërndajë pronën tek kreditorët me kërkesa të vlefshme, dhe bëjë kontabilitetin përfundimtarë në gjykatë.

B. Kreditorët e Siguar mbesin të Siguar

Rregulli i përgjithshëm i zbatueshëm për Procedurat e Riorganizimit dhe Likuidimit është që kreditorët e siguar mbesin të siguar. Përveç nëse gjykata merr vendim ndryshe, barra e kreditorit do të kalojë përmes falimentimit e paprekur. Kjo nënkupton se nëse debitori është në mungesë të një borxhi të siguar, kreditori mund ende të heq apo të merr kolateralin (edhe pse do ti duhet të presë deri sa të hiqet moratoriumi në mënyrë që të veprojë ashtu) edhe pse detyrimi personal i debitorit hiqet

me lirimin. Debitori mund të paraqesë një propozim për të shmangur apo larguar një barrë gjykimi që dëmton përjashtimet e tij. Një përjashtim tjetër i disponueshëm në mënyrë unike në procedurë të likuidimit është riblerja e pronës personale e cila zakonisht përjashtohet për zbatim sipas Ligjit për Procedurën Përmbartimore (National Consumer Law Center (NCLC), 2015; National Consumer Law Center (NCLC), 2015).

C. Shitja e Aseteve

Administratori është përgjegjës për organizimin e shitjes së asetëve të Debitorit në procedurën e Likuidimit.

Shitja e asetëve mund të ndodhë ose përmes organizimit të një *ankandi publik*, angazhimin e një *shtëpie ankandi* apo mund të organizohen *metoda të tjera të ofertimeve publike* për shtijën e asetëve të organizatës.

Kur të vendoset çmimi minimal për shitjen e asetëve të organizatës, Administratori do të marrë për bazë vlerësimin e atyre asetëve nga profesionistët e angazhuar dhe do të bëjë përpjekjet maksimale që çmimi fillestar i asetëve të jetë në nivelin apo *afër shumës së borxheve* të organizatës në falimentim. Vetëm nëse niveli i shumave afër shumës së borxhit nuk mund të arrihet, Administratori do të kërkojë nga Gjykata që të lejojë shitjen e asetëve me çmimin më të lartë të ofruar në treg, dhe pa procedura të ofertimeve publike.

D. Përmbushja e Kërkesave.

Kërkesat përmbushen në përputhje me listën e përparësive të shpjeguar në Kapitullin IV, pjesa D e këtij Manuali. Përmbushja e kërkesave së kategorisë më të ulët bëhet vetëm pas përmbushjes së plotë të kërkesave me prioritet të lartë.

Shembull: Asetet e Debitorit Pako SH.A. janë likuiduar. Shuma neto e të ardhurave nga shitja e asetëve është € 240,500.00. Kërkesat e siguruara kundrejt PAKO SH.A. janë në shumën e €195,500.00. Përpos kësaj, janë edhe € 5,000 për paga dhe mëditje për administratorin nga periudha e kaluar të cilën ai ende nuk e pranuar, € 50,000 janë kërkesa të palëve me interes të PAKO SH.A., € 4,000 duhet të paguhet ekspertët e angazhuar nga administratorët gjatë administrimit të rastit; dhe € 5,000 janë borxh i kartave bankare, € 15,000 për shpenzimet e administratorit, € 15,000 për mirëmbajtjen e shpenzimeve të ndodhura pra likuidimit të pasurisë falimentuese, € 10,000 për shpenzimet e gjykatës.

Këto kërkesa përmbushen si në vijim:

		<u>Shuma e mbetur</u>
1. Kërkesat e siguruara	€ 195,500	€ 45,000
2.1. Shpenzime për Gjykatë	€ 10,000	€ 35,000
2.2. Shpenzimet e Administratorit	€ 15,000	€ 20,000
2.3. Tarifa e Administratorit	€ 5,000	€ 15,000
2.4. Shpenzimet e mirëmbajtjes	€ 15,000	€ 0
2.5. Pagesat e ekspertëve	€ 4,000	Të papaguara
3. Borxhi i Kartelave Bankare	€ 5,000	Të papaguara
4. Kërkesat e palëve me interes	€ 50,000	Të papaguara

Kur burimet janë të pamjaftueshme për të përmbushur plotësisht gjitha kërkesat në një kategori të caktuar, kërkesat e kategorisë së tillë do të përmbushen proporcionalisht me shumën e secilës kërkesë.

Shembull: Pas përmbushjes së kërkesave me përparësi të lartë, € 5,000 mbetin për përmbushjen e kategorisë së kërkesave të pasiguruara:

KËRKESA 1 = €4,000 44.4% të totalit të kërkesave të pasiguruara
KËRKESA 2 = €3,000 33.3% të totalit të kërkesave të pasiguruara
KËRKESA 3 = €1,000 11.1% të totalit të kërkesave të pasiguruara
KËRKESA 4 = € 500 5.6% të totalit të kërkesave të pasiguruara
KËRKESA 5 = € 500 5.6% të totalit të kërkesave të pasiguruara
GJITHSEJTË = € 9,000 100% të totalit të kërkesave të pasiguruara

Kërkesat përmbushen si në vijim:

KËRKESA 1 pranon € 5,000 x 0.444 = € 2,220
KËRKESA 2 pranon € 5,000 x 0.333 = € 1,665
KËRKESA 3 pranon € 5,000 x 0.111 = € 555
KËRKESA 4 r pranon € 5,000 x 0.056 = € 280
KËRKESA 5 pranon € 5,000 x 0.056 = € 280
GJITHSEJTË € 5,000

Fatkeqësisht, procedurat për pagesën e kërkesave mbetin të përkufizohen nga rregullat e ekzekutimit, të cilat duhet të përgatiten në të ardhmen. Pa procedurat e pagesave të kërkesave, procesi i përmbushjes së kërkesave mbetet i bllokuar.

E. Shndërrimi i rastit të likuidimit në riorganizim

Pas miratimit të gjykatës, Administratori mund të shndërrojë një rast të likuidimit në një rast të riorganizimit nëse Administratori mund të dëshmojë para gjykatës se kreditorët e pasiguar do të realizonin mjaft shumë përmbushjen e kërkesave të tyre. Me shndërrimin në riorganizim, Administratori do të *vazhdojë* si përfaqësues i pasurisë falimentuese.

F. Realizimi i shpërndarjeve – Parimi Pari Passu

Asnjë shpërndarje nuk realizohet ndaj asnjë klase të kërkesave të pasiguruara apo bartësve të ekuitetit derisa kreditorët në klasat më të larta me prioritet më të lartë të jenë paguar plotësisht. Një shpërndarje e realizuar do të konsiderohet secili lloj i pagesës që ka pranuar kreditori për një detyrim të debitorit nga çfarëdo burimi tjetër ndaj pasurisë falimentuese. Nëse nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar në tërësi një klasë të kreditorëve, atëherë shpërndarja do të bëhet sipas parimit pari passu në mes të kreditorëve të asaj klase.

G. Përparësia e kërkesave dhe Shpërndarjeve

Kërkesat e *siguruara* kanë prioritet ndaj kërkesave të pasiguruara.

Kërkesat e *pasiguruara* kanë përparësi në procedurë të likuidimit ndaj interesave në ekuitet, dhe Administratori mund të bëjë shpërndarjen për kërkesat e tilla të pasiguruara pasi të ketë realizuar shpërndarjen ndaj kërkesave të siguruara, ose pasi të ketë ndarë rezervën në mënyrë adekuate për pagesën e kërkesave të siguruara.

Gjitha kërkesat e pasiguruara supozohet se kanë prioritetin e njëjtë për qëllime të shpërndarjes përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj. Prioritetet e pagesës së kërkesave të pasiguruara radhiten si vijon:

1. *shpenzimet administrative* paguhen në radhë të parë;
2. në radhë të dytë, paguhen kërkesat të cilat rrjedhin nga *marrëdhëniet familjare* ose kërkesat për kompensimin e viktimave;
3. në radhë të tretë paguhen *kërkesat nga marrëdhënia e punës*;
4. në radhë të katërt paguhen kërkesat *tatimore*;
5. në fund, paguhet çfarëdo *kërkese e mbetur e pasiguruar*.

Shpenzimet administrative përfshijnë:

- pagat e mbledhura pas hapjes së rastit të falimentimit;
- obligimet tatimore të akumuluar prej momentit të hapjes së rastit të falimentimit;
- kërkesat e ndërlidhura me një hua ose kredi për të cilën përfaqësuesi i pasurisë falimentuese ka marr aprovimin nga gjykata; dhe
- tarifatat dhe shpenzimet e profesionistëve të punësuar me aprovim të gjykatës, përfshirë, por pa u kufizuar, në kompensimin e Administratorit apo profesionistëve të tjerë, për të gjitha shpenzimet dhe kompensimet e realizuara pas hapjes së rastit të falimentimit.

Kërkesat nga marrëdhëniet familjare dhe kërkesat për kompensim të viktimave përfshijnë:

- gjitha kërkesat që kanë lindur para inicimit të procedurës së falimentimit që ndërlidhen me divorcin, kujdestarinë, alimentacionin
- çështje të tjera të rregulluara sipas Ligjit për Familjen.
- Kërkesat për kompensim të viktimave të cilat rrjedhin nga ndonjë aktivitet penal të debitorit.

Kërkesat nga marrëdhënia e punës përfshijnë gjitha kërkesat e punëtorëve të krijuara para inicimit të procedurës së falimentimit, për punëtorët të cilët kanë qenë të angazhuar për debitorin përmes kontratës së punës, në përputhje me depozitat e Ligjit të Punës në Kosovë.

Kapitulli IX:

Lirimi nga borxhet dhe Mbyllja e Procedurës së Likuidimit

A. Lirimi.

Shumica e llojeve të rasteve të falimentimit në mënyrë ideale kulmojnë me një “lirim” të shumë apo gjithë borxheve para ekzistuese të debitorit. Përgjithësisht, lirimi:

- zhvlerëson çfarëdo gjykimi deri në masën që një gjykim i tillë është përcaktues i detyrimit personal të debitorit sa i përket borxhit të liruar; dhe
- vepron si një ndalesë ndaj fillimit ose vazhimit të çfarëdo veprimi apo procedure për të mbledhur apo kthyer borxhin e liruar. (Kevin M. Lewis, 2018).

Një aktvendim i lirimit nuk i liron kërkesat kundër debitorit të cilat rrjedhin pasi debitori të ketë depozituar kërkesën për falimentimit. Për më tepër, me disa përjashtime, barrat kundër pronës së debitorit përgjithësisht “vazhdojnë të jenë në fuqi pavarësisht hyrjes në fuqi të një lirimi të falimentimit”. Gjithashtu, sipas disa rrethanave, Gjykata mund të refuzojë lirimin për debitorin i cili do të mund të kishte drejtë të pranojë një lirim të tillë. Për shembull, Gjykata mund të refuzojë lirimin për ndonjë debitor i cili ka bërë sjellje jo të mira gjatë rastit të falimentimit apo ka dështuar që të përmbush kërkesa të caktuara të Ligjit për Falimentimin. Debitori i cili aplikon për falimentim për herë të dytë shumë shpejtë pas pranimit të lirimit në një rast të mëhershëm të falimentimit mund të mos ketë të drejtë të pranojë lirim nga borxhi (10 vite në mes të procedurave të falimentimit). Raste të tjera kur Gjykata mund të përjashtojë Debitorin nga pranimi i lirimit nga borxhi përfshijnë:

- Kur debitori nuk ka bashkëpunuar me Administratorin;
- Kur debitori ka fshehur një pjesë të pasurisë nga kreditorët, gjykata dhe Administratori;
- Kur debitori ka dorëzuar çfarëdo dokumenti në rastin i cili ka qenë i falsifikuar, mashtrues apo çorientues;
- Kur debitori ka ndryshuar apo në ndonjë formë ka modifikuar librat dhe shënimet e tij tatimore gjatë periudhës një (1) vjeçare para fillimit të rastit të falimentimit duke i bërë këta libra dhe shënime të pasakta, mashtruese ose çorientuese; dhe
- Kur debitori nuk i ka mbajtur librat dhe shënimet tatimore në mënyrë të rregullt gjatë periudhës një vjeçare para fillimit të procedurës falimentuese.

Një debitor i cili është individ lirohet në tërësi nga të gjitha kërkesat të cilat kanë ekzistuar në periudhën apo para fillimit të procedurës së falimentimit deri kur ka filluar procedura e falimentimit. Debitori i cili është individ i shlyhen të gjitha borxhet e krijuara deri:

- në momentin e konfirmimit të planit të riorganizimit; ose
- deri në momentin e mbylljes së rastit të likuidimit.

Debitori i cili nuk është individ do të lirohet nga borxhet ndaj të gjitha kërkesave që kanë ekzistuar deri:

- në momentin e konfirmimit të planit të riorganizimit; ose
- deri në momentin e mbylljes së rastit të likuidimit apo njoftimin e regjistrimit të bizneseve dhe administratës tatimore mbi mbylljen e rastit, varësisht se cilado nga këto të ndodhë e fundit.

B. Mbyllja e rastit.

Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Falimentimin, gjykata mund të mbyll rastin kur:

1. administratori ka shndërruar të gjitha pronat e pasurisë falimentuese në para të gatshme, ose ka shndërruar të gjitha ato prona që kanë mundur të shndërrohen në para të gatshme dhe ka bërë shpërndarjen e të gjitha pronave të pasurisë falimentuese të kreditorët; ose
2. administratori e njofton gjykatën se administrimi i mëtutjeshëm i rastit nuk do të sjell rritje të shpërndarjes për kreditorët e pasiguruar

C. Dispozita specifike sa i përket llojeve të ndryshme të Organizatave Biznesore.

Shoqëritë Aksionare dhe Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K. dhe SH.A.)

Administratori do të ndërmerr veprime për të shpërndarë dhe ndërprerë ekzistencën e një Ndërmarrje pa pasur nevojën që të thërret ndonjë nga takimet e kërkuara të mbajtësve të kapitalit; me kusht, që Administratori do të sigurojë njoftimin e regjistrimit të bizneseve dhe administratës tatimore në lidhje me mbylljen e rastit.

Vetëm Administratori do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesa të cilat lindin nga ndonjë Ligj tjetër përpos Ligjit për Falimentimin, në emër të kreditorëve ndaj aksionarëve, zyrtarëve, drejtorëve, agjentëve apo menaxhmentit të lartë të ndërmarrjeve me përgjegjësi të kufizuar. E drejta e paraqitjes së kërkesave do të skadojë në momentin e mbylljes së rastit të falimentimit ose më së largu dy (2) vite nga data kur rasti i falimentimit është hapur.

Ortakëritë e Përgjithshme dhe të Kufizuara

Në rastet kur debitori është ortak i përgjithshëm në ortakëri të përgjithshme të themeluar sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në momentin e mbylljes së rastit, në përputhje me dispozitat e parapara në këtë Kapitull dhe në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Administratori do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për shuarjen e ekzistencës së ortakërisë së përgjithshme pa nevojën e thirrjes së takimit të partnerëve. Veprimet e ndërmarra nga Administratori lidhur me shuarjen e ortakërisë do të përfshijnë dhënien e njoftimit tek regjistri i bizneseve dhe administratës tatimore sa i përket mbylljes së rastit.

Vetëm Administratori, ka të drejtë të paraqesë kërkesa që rrjedhin nga një Ligj tjetër përpos Ligjit për Falimentimin, në emër të kreditorëve ndaj promovuesve, partnerëve, zyrtarëve, drejtorëve, agjentëve apo menaxhmentit të lartë të ortakërisë së përgjithshme. E Drejta për të paraqitur kërkesa skadon në momentin e mbylljes së rastit të falimentimit ose më së largu dy (2) vite nga dita e hapjes së rastit të falimentimit. Shuma e kërkesave të tilla do të kufizohet në shumën për të cilën ortaku i përgjithshëm ka një përgjegjësi të pakufizuar personale për pagesë në përputhje me ligjet e tjera të zbatueshme në Kosovë.

Administratori ka një kërkesë kundër pasurisë së secilit ortak të përgjithshëm në një shoqëri të tillë të përgjithshme ose shoqëri komandite, për të mbuluar shumën e të gjitha kërkesave të kreditorëve ndaj shoqërisë së përgjithshme ose të shoqërisë komandite. Kërkesa e Administratorit nën këtë nënseksion ka të drejtë për të njëjtin trajtim në shpërndarje të kreditorët si çdo kërkesë tjetër. Nëse shumat që Administratori i kthen nga pasuritë është më e madhe se çdo mungesë që nuk është rikuperuar, gjykata, pas njoftimit dhe një seance dëgjimore, do të përcaktojë një shpërndarje të arsyeshme të tepricës në mënyrë të rikuperuar, dhe Administratori do t'ua shpërndajë këtë tepricë partnerëve të përgjithshëm sipas përcaktimit të tillë gjyqësor.

Bizneset Individuale

Pas pranimit të lirimit ose mbylljes së rastit, debitori individual i cili është biznes individual do të ndërpres të gjithë aktivitetin afarist sipas emrit tregtar ose cilitdo emër që e ka përdorur në tregti, ose cilindo emër të cilin e ka përdorur para pranimit të lirimit ose mbylljes së rastit.

Pas njoftimit dhe seancës dëgjimore, gjykata mund të lejojë Administratorin shitjen e emrit tregtar apo elementeve të tregtisë së debitorit individual të përdorura para prairimit të lirimit, e cila mund ti bëhet debitorit apo cilësdo palë të interesuar.

Kapitulli X:

NVM-të dhe procedurat e përsheptuara

A. Kriteret për NVM-të

Bazuar në Ligjin për Falimentimin, NVM-të përcaktohen si biznese të cilat kanë 25 apo më pak punëtor dhe më pak se €1,000,000 qarkullim vjetor. Nëse Debitori kualifikohet, atëherë mund të zgjedhë të trajtohet sipas rregullave të veçanta të NVM-ve. Zgjedhja për tu trajtuar sipas rregullave të NVM-ve duhet të bëhet brenda dhjetë ditëve nga hapja e rastit. Edhe nëse bën këtë zgjedhje, shumica e dispozitave të riorganizimit vazhdojnë të aplikohen përpos nëse specifikohet ndryshe. Për shembull, një rregull i cili është mbajtur i njëjtë në të dy llojet e rasteve është *testi i interesit më të mirë të kreditorëve*: propozuesi i planit duhet të tregojë se prona e shpërndarë apo e cila do të shpërndahet sipas planit, duhet, për secilin kreditor, të jetë e barabartë apo të tejkalojë atë se çfarë debitori do të kishte pranuar nëse do të ishte rast i likuidimit.

Nëse debitori zgjedh trajtimin sipas NVM-ve, janë disa dallime kyçe nga procedura e rregullt e riorganizimit. Fillimisht, dallimi i parë në një rast të NVM-ve është shpejtësia e tij. Një NVM duhet të dorëzojë planin brenda tridhjetë ditëve nga hapja e rastit, dhe pas kërkesës së një pale të interesuar, gjykata duhet të hedhë poshtë rastin nëse plani nuk konfirmohet brenda gjashtëdhjetë ditëve nga koha e paraqitjes.

B. Emërimi i Monitoruesit

Një dallim i dytë është se në secilin rast të NVM gjykata emëron një monitorues, i zgjedhur nga administratorët e rregullt të rastit të likuidimit. Ky monitorues konsultohet me debitorin sa i përket çështjeve afariste dhe sa i përket përmbytjes së ndonjë plani i cili do të paraqitet. Monitoruesi është gjithashtu përgjegjës për vlerësimin e fizibilitetit të planit. Detajet për rolin e Monitoruesit janë paraparë në Kapitullin II, pjesa C e këtij Manuali.

C. Ndryshimi i votimit tradicional të kreditorëve

Ndryshe nga rregullat e shumicës së thjeshtë për riorganizimet e rregullta, gjykata do të konfirmojë një plan të riorganizimit të NVM-ve vetëm nëse 75% e të gjitha klasave të siguruara votojnë të aprovojnë, dhe të paktën 33% e të gjitha klasave të pasiguruara votojnë të aprovojnë (shih Kërkesat e Votimit në Kapitullin VI, pjesa C e këtij Manuali). Ky votim disi i pazakontë u motivua nga kuptimi se NVM-të nuk do të mbijetojnë në Kosovë pa mbështetjen e bankës së tyre ose kreditorit tjetër të siguruar. Si diskutim, ngushtimi i borxhit bankar për NVM-të nuk është realist. Shuma e ulët e caktuar për klasat e pasiguruara pasqyron nevojën për ndonjë mbështetje, por nëse tre të katërtat ose më shumë e kreditorëve të siguruar mbështesin planin dhe nëse plotësohet testi i interesit më të mirë i kreditorëve (i cili është gjithashtu një kërkesë), atëherë kreditorët e pasiguar janë mbrojtur.

Aplikimi për lirim i debitorit të NVM-ve bazuar në Kapitullin II të Ligjit për Falimentimin (Procedurat e Shpejta të NVM-ve) ka kërkesa të ndryshme për miratimin e Planit të Riorganizimit. Neni 14 i Ligjit për Falimentimin parashikon që një debitor i NVM-ve mund të konfirmojë një plan pa përmbushur të gjitha kërkesat e Kapitullit VI të Ligjit për Falimentimin (kërkesat e renditura më sipër), nëse Gjykata gjën se secila prej këtyre kushteve janë përmbushur:

- brenda dhjetë (10) ditëve nga inicimi i procedurës së falimentimit, i deponon gjykatës kërkesën me shkrim për zbatim të Kapitullit II;

- monitoruesi ka paraqitur në gjykatë raportin mbi realizueshmërinë e planit dhe raporti i është dorëzuar të gjitha palëve të interesuara para fillimit të procedurës së votimit;
- i është dorëzuar të gjithë kreditorëve të prekur nga plani për votim, dhe plani aprovohet nga:
 - shtatëdhjetë përqind (75%) e të gjitha klasave të kreditorëve të siguruar; dhe
 - së paku 33.33% e të gjithë kreditorëve të pasiguruar votojnë në favor të planit;
- gjykata nxjerr konkluzion se plani është i realizueshëm kur:
 - nëse Monitoruesi nuk e ka dorëzuar raportin (dhe plani konsiderohet i realizueshëm nëse nuk ka reagim nga Monitoruesi);
 - së paku pesëdhjetë përqind (50%) e gjithë kreditorëve të pasiguruar të cilët votojnë për planin e pranojnë atë;
 - në të gjitha rastet tjera, debitori duhet të dëshmojë se plani është i realizueshëm;
 - ose, kur të gjithë kreditorët e siguruar të cilët votojnë për riorganizim e pranojnë planin;
- debitori dëshmon se plani do t'i paguajë të gjithë kreditorët e prekur jo më pak se sa do të realizonin ata në rast se debitori do të paraqiste kërkesë për likuidim.

D. Një qasje tjetër për të përcaktuar realizueshmërinë

Një ndryshim me procedurat e tjera është se si të përmbushen kërkesat e realizueshmërisë. Kjo mund të plotësohet në katër mënyra të ndryshme.

- Së pari, nëse ka mbështetje unanime nga të gjitha klasat e kreditorëve të siguruar, plani konsiderohet i realizueshëm. Ideja pas kësaj është që nëse të gjitha bankat (ose nëse e vetmja bankë) mbështesin planin, atëherë interesi i tyre personal mund të shërbejë si një përfaqësues i përafërt për realizueshmërinë në të ardhmen;
- Së dyti, sapo debitori të vendosë votimi për kreditorët, nga monitoruesi kërkohet të kryejë vlerësimin e tij të fizibilitetit. Ndërsa monitorët tërhiqen nga grupi i administratorëve të falimentimit, ata duhet të kenë njohuri për përcaktimet e tilla. Në këtë pikë, megjithatë, efekti i përgjigjes së monitorit është hequr nga roli tradicional: monitoruesi raporton vetëm nëse ai ose ajo beson se plani nuk është i realizueshëm. Heshtja në këtë rast trajtohet si një aprovim i heshtur i realizueshmërisë së planit. Ky opsion u zgjodh për të ruajtur kostot.
- Së treti, nëse kreditorët e pasiguruar aprovojnë planin nga 50% e kreditorëve të pasiguruar, fizibiliteti përsëri konsiderohet i pranishëm. Baza për këtë metodë është se për shkak se kreditorët e pasiguruar kanë mbrojtjen e testit të interesit më të mirë, çdo votë është me të vërtetë mbi alokimin e tepriçës së interesit në vazhdim. Tradicionalisht, teprica e problemeve në vazhdim është vendosur dhe ndarë me shumicën e votave. Me një shumicë votash të kreditorëve të pasiguruar, dhe një shumicë të votave të kreditorëve të siguruar, koha dhe kostoja e një prove të realizueshmërisë do të ishin përgjithësisht të kota.
- Së fundmi, debitori mund të zgjedhë të provojë realizueshmërinë sikur të mos ishte në një rast i NVM-ve

E. Heqja e Rregullit me Përparësi Absolute për NVM-të

Heqja e rregullit të përparësisë absolute është diçka e re në Ligjin për Falimentimin - rregulli që i gjithë borxhi duhet të paguhet i plotë ose pëlqimi para se mbajtësit e kapitalit të mbajnë ndonjë interes. Këtu, arsyetimi është se vijat e paqarta midis vlerës së sipërmarrësit dhe njësisë nuk justifikojnë domosdoshmërinë e kerkimit të pagesës së plotë si kusht konfirmimi. Në vazhdim, mbrojtja themelore është ajo që sigurohet nga testi i interesit më të mirë. Nëse kërkohet përgjegjësia e pronarit / sipërmarrësit, kreditori ka pasur gjithmonë aftësinë për të negociuar për një garanci personale.

Bibliografia

City Bar Justice Center; New York City Bar. (2016). *Bankruptcy Basics: A guide for Employees whose Employer Files for Bankruptcy*. New York, NY: American College of Bankruptcy Foundation.

Kevin M. Lewis. (2018). *Bankruptcy Basics: A Primer*. Washington D.C.: Congressional Research Service (www.crs.gov).

Lawson, E. G. (2020). *EdLawson Law*. Retrieved from <http://www.edlawsonlaw.com/voluntary-involuntary-bankruptcy/>

Lindsey Simon, A. P. (2019, August 29). *The Conversation*. Retrieved from Business & Economy: <https://theconversation.com/why-companies-file-for-bankruptcy-and-how-it-protects-both-debtors-and-creditors-113101>

Shtojca 1:

Aktvendim mbi refuzimin e kërkesës (kur paraqitet nga Debitori)

III.EF.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren _____, duke vendosur lidhur me kërkesën e propozuesit _____, me vendbanim në _____, me adresë “ _____ ” nr. __, për hapjen e procedurës së falimentimit të Shoqërisë tregtare “ _____ ” me NRB _____, me seli në _____, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit _____ avokat nga _____, në prani të të autorizuarit të debitorit vullnetar të falimentimit, të autorizuarit të kreditorit si dhe administratorit të falimentimit _____, me datën 08.06.2018, mori këtë:

AKTVEINDIM

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar propozimi i propozuesit _____, për hapjen e procedurës së falimentimit, likuidimin e Shoqërisë tregtare “ _____ ” Sh.p.k. me NRB _____, me seli në _____, dhe lirim nga të gjitha obligimet financiare ndaj kreditorit _____, me seli në _____.
- II. DETYROHET propozuesi _____, që ti paguajë Administratorit të Falimentimit z./znj. _____ shumën prej _____ €, në xhironlogarinë _____ pranë Bankës _____ në Prishtinë.

Arsyetim

Propozuesi/debitori _____ në cilësinë e pronarit të Shoqërisë tregtare “ _____ ” Sh.p.k. me NRB _____, me seli në _____, ka propozuar fillimin e procedurës së falimentimit, si përgjigje ndaj paaftësisë paguese të debitorit. Ka treguar se paaftësia paguese është vërtetuar nga pamundësia e arkëtimit të kërkesave prej debitorëve të tij, respektivisht pagimit të borxheve të disa kreditorëve të parashtruesit të kërkesës, andaj shoqëria është insolvente për pagimin e borxheve ndaj _____, me seli në _____, duke kërkuar që shoqëria _____ të shpallet e likuiduar dhe të lirohet nga të gjitha detyrimet financiare ndaj kreditorës.

Shpenzimet e procedurës së falimentimit nuk i ka kërkuar.

I autorizuarit i kreditorit ka qëndruar në tërësi pranë kërkesës me shkrim të datës ____--, duke theksuar se firma “ _____ ” i ka borxh _____, shumën prej _____ €, dhe e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për falimentim dhe e ka mbështetur kërkesën e administratorit të falimentimit për refuzim të procedurës së falimentimit.

Administratori i falimentimit me datën _____ ka paraqitur Raportin financiar në të cilin ka konstatuar se debitori nuk ka pasuri të mjaftueshme e cila do të siguronte rrjedhjen e procedurës së falimentimit dhe kjo situatë ka ardhur për shkak se debitori nuk e ka deponuar kapitalin themeltar të deklaruar të shoqërisë, në shumë prej 10,000.00 €. Ka konstatuar se sikur të ishte deponuar kapitali themeltar debitori do të kishte mjete të mjaftueshme për ta paguar borxhin ndaj kreditorës, ndërsa për shkak të mospagesës së kapitalit themeltar debitori nuk ka paftësi paguese andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit të hudhet poshtë si e palejueshme sepse debitori nuk është i përshtatshëm për të qenë debitor sipas Ligjit për Falimentim.

Shpenzimet e procedurës së falimentimit i ka kërkuar.

Gjykata për të vendosur lidhur me këtë çështje juridike ka administruar provat, si në vijim:

- Certifikata e,
- Faturat tatimore të dt.,
- Formulari i deklarimit vjetor dhe i pagesës për tatim dt.,
- Raporti financiar për shoqërinë tregtare e dt.,
- Pasqyrat e kapitalit prej dt. – dt.,
- pasqyra e të ardhurave prej dt. - dt.,
- pasqyra e ndryshimeve të ekuitetit dt. - dt.,
- gjendja e borxheve e dt.,
- gjendja e përgjithshme e transaksioneve të tjera si dhe kërkesa e administratorit e dt.,
- etj.

Provat e propozuara dhe të administruara, deklaramet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse dhe të administratorit të falimentimit, gjykata i vlerësoi, në vështrim të nenit 8 të ligjit për falimentim (Nr.05/L-083), dhe konstatoi këtë gjendje faktike:

Nga Raporti i administratorit të falimentimit të datës dt., gjykata ka gjetur se debitori vullnetar përkatësisht propozuesi për falimentim nuk ka pasuri të mjaftueshme e cila do të siguronte rrjedhjen e procedurës së falimentimit. I njëjti posedon _____, i cili nuk përbën ndonjë vlerë materiale e cila mund të mbulonte procedurën e falimentimit. Shoqëria Tregtare e debitorit është i regjistruar pranë ARBK-ës, dhe në dokumentet themelore-kapital themelor është në shumë prej _____ €. Mirëpo kjo shumë e kapitalit nuk është deponuar asnjëherë nga hisedari i vetëm i kompanisë.

Gjykata konstaton se hisedari ka detyrim ligjor për ta paguar kapitalin themelor gjegjësisht shumën prej 10,000.00 euro. Me pagesën e kësaj shume debitori vullnetar i falimentimit ka mundësi që ta paguaj borxhin ekzistues ndaj ATK-ës, dhe pastaj të vazhdoj veprimatrinë (operimin) ose të bëj likuidimin vullnetar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Propozuesi apo debitori vullnetar i falimentimit ka paraqitur kërkesë për falimentim sipas nenit 19 të ligjit për falimentimin duke pretenduar pamundësinë e pagesës së detyrimeve tatimore, të cilat detyrime janë të barazvlefshme me shumën e kapitalit themeltar të shoqërisë, të cilën hisedari sipas ligjit ka qenë i detyruar ta paguaj.

Debitori nuk ka marr asnjë veprim për ta përmbushur obligimin ligjor për pagesën e kapitalit themeltar nga i cili do të paguheshin detyrimet e shoqërisë, por ka zgjedhur procedurën e falimentimit me qëllim që hisedari të lirohet apo të mos e paguaj borxhin ndaj kreditorit. Në këtë rast paaftësia paguese e debitorit sipas pretendimeve të vetë debitorit apo propozuesit të falimentimit konsiston në pamundësinë e arkëtimit të borxheve të shoqërisë nga debitorët e saj.

Me paraqitjen e kërkesës për likuidim synohet që të mënjanohet përgjegjësia e hisedarit për borxhin ndaj ATK-së, prandaj gjykata ka gjetur se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për hapjen e rastit të falimentimit sepse nuk ekziston paaftësia paguese e debitorit (paraqitësit të kërkesës për falimentim). Sipas nenit 90 Ligjit për Shoqëri Tregtare (LIGJI Nr. 02/L-123) përcaktohet se: “Një pronar është i detyruar që shoqërisë t’ia paguajë të gjitha kontributet me afat, sipas statutit apo marrëveshjes së shoqërisë apo sipas ndonjë marrëveshje tjetër të pronarit. Ky detyrim nuk mund të arsyetohet për shkak të vdekjes, paaftësisht, ose paaftësisë tjetër për pagim të pronarit”. Prandaj, hisedari është i obliguar që të paguaj kontributet e parapara në kapitalin themeltar. Sipas nenit 79.4 të ligjit për Shoqërinë Tregtare, përcaktohet se: “Përderisa shoqëria të dorëzoj në afat tek Zyra e Regjistrimit dëshminë mbi pagesën e kapitalit themeltar, shoqëria nuk mund të angazhohet në veprimtari tregtare në Kosovë. Personi që vepron në emër të shoqërisë pas regjistrimit por para dorëzimit të dëshmive në fjalë në këtë zyrë është bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si pasojë e veprimeve të tilla, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga palët e treta. Pasi që shoqëria t’i ketë siguruar Zyrës së Regjistrimit dëshmi mbi pagimin e kapitalit themeltar, shoqëria mund të marrë përsipër përgjegjësinë për pretendimet dhe detyrimet e tilla; në raste të këtilla, shoqëria është e vetmja palë përgjegjëse për pretendimet dhe detyrimet”, kështu që pasi që hisedari nuk e ka deponuar shumën për kapitalin themeltar deri në shumën prej 10,000.00 euro, ai është përgjegjës personalisht për detyrimet ndaj ATK-së.

Nga statuti i shoqërisë “_____” Sh.p.k. i datës _____, përkatësisht sipas nenit 14 të Statutit ceket se “Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është shoqëri tregtare themeluesi i të cilës nuk përgjigjet për obligimet e shoqërisë mirëpo bart rrezikun për afarizmin e saj në lartësinë e kontributit të investuar në shoqëri. Kontributet e anëtarëve të shoqërisë përbëjnë kapitalin the-

meltar të saj”, prandaj duke e bazuar në nenin 79 par.4 të ligjit për Shoqëritë Tregtare si dhe në nenin 14 të statutit të shoqërisë debitori vullnetar-hisedari mbanë përgjegjësi për obligimet në shumën e kapitalit të regjistruar, kështu që në rastin konkret debitori duhet të kërkoj pagesën e kapitalit themeltar nga hisedari në shumë prej 10,000.00 euro, dhe të paguaj detyrimet ndaj ATK-ës.

Në rastin konkret kreditori i vetëm i njohur është ATK-ja, dhe në rast të vazhdimit të procedurës mjetet do të inkasohen nga aksionari i debitorit dhe do të shpenzoheshin në procedurën e falimentimit për shpenzimet procedurale. Meqënëse debitori nuk ka asetet tjera atëherë kreditori përkatësisht ATK-ja, do të kishte mbetur pa realizuar borxhin.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata iu referua nenit 21 të Ligjit për Falimentim, i cili përcakton se: “Gjykata e hedh poshtë si të palejueshme kërkesën për inicim të procedurës së falimentimit nëse” par. 1.2 “debitori nuk është i përshtatshëm për të qenë debitor sipas këtij ligji”.

Nga të lartcekurat gjykata ka konstatuar se hisedari i vetëm nuk e ka deponuar shumën e kapitalit themeltar andaj sipas nenit 79.4 të Ligjit për Shoqëri Tregtare dhe nenit 14 të Statutit të Shoqërisë i njëjti mbanë përgjegjësi personale për detyrimet e veta ndaj Administratës Tatimore të Kosovës në shumën prej _____€, andaj këtë shumë duhet personalisht ta paguaj propozuesi i kërkesës së falimentimit përkatësisht hisedari i vetëm i shoqërisë “_____” Sh.p.k.

Bazuar në dëshmitë dhe faktet e cekura më sipër, gjykata e ka refuzuar kërkesën për falimentim dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 8, dhe nenin 449 të LPK-së, neni 21 par. 1.2, nenin 19 dhe 57 par. 2.4 të Ligjit për Falimentim si dhe neni 90, 79.4 të Ligjit për Shoqëri Tregtare, për arsye se kërkesa për likuidim vullnetar është bërë për qëllime joadekuate pasi nuk ekziston paaftësia paguese e debitorit dhe procedura e falimentimit do të dëmtonte kreditorët andaj debitori nuk është i përshtatshëm për të qenë debitor sipas këtij Ligji. Prandaj vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për hapjen e rastit të falimentimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike
III.EF.nr.1/2019, me datë _____

Gjyqtari

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të të njëjtit, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Shtojca 2:

Aktvendim për Konsolidimin e Rasteve

EF.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË –Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin _____, në çështje juridike të kreditorëve 1. “XX” _____ me seli në _____ dhe “XY” _____ me seli në _____, dhe kreditorëve 2. “CC” dhe “DD” me seli në _____ përkatësisht, pas shqyrtimit të kërkesave të kreditorëve për hapjen e procedurës së falimentimit kundër debitorit “AA” _____ me seli në _____, dhe debitorit “BB” _____ me seli në Prishtinë, gjykata duke vepruar sipas nenit 23 të ligjit për falimentim (ligji nr.05/L-083), dhe nenit 387 pika h të LPK-së, me datë _____ merr këtë:

AKTVENDIM

Bashkohet-konsolidohen lëndët e falimentimit të evidentuar me nr. EF.nr. _____ dhe Ef.nr. _____, dhe tani e tutje këto raste do të administrohen bashkërisht ndërsa procedura e falimentimit do të zhvillohet sipas numrit të evidentuar me Ef.nr. _____

Arsyetim

Në këtë gjykatë sipas propozimit të kreditorëve “XX” _____ me seli në _____ dhe “XY” _____ me seli në _____, me Aktvendimin EF.nr. _____ është hapur procedura e falimentimit ndaj debitorit “AA” _____ me seli në _____. Po ashtu sipas propozimit të kreditorëve 2. “CC” dhe “DD” me seli në _____, është hapur procedura e falimentimit ndaj debitorit “BB” _____ me seli në _____.

Nga shkresat e lëndës rezulton se të dy shoqëritë ndaj të cilave është hapur procedura e falimentimit janë entitete të ndërlidhura sepse _____ është themeluesi dhe aksionari i vetëm i 100% të aksioneve në _____. Zbatimi i kërkesave të kreditorëve ndaj dy shoqërive është drejtpërdrejtë i lidhur nga epilogu i procedurës së falimentimit të shoqërisë tjetër pasi që nga provat që gjenden në shkresat e lëndëve rezulton se të dy shoqëritë zhvillojnë aktivitete të përbashkëta afariste dhe shfrytëzojnë të njëjtat asete gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre. Andaj, pasuria e falimentimit të secilës nga shoqëritë nuk mund të përcaktohet qartë. Për më tepër secila nga shoqëritë ka garantuar përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë tjetër duke lënë peng asetet dhe interesat për shoqërinë tjetër. Si pasojë, zhvillimi i ndarë i procedurës së falimentimit së njëjës shoqëri do të rrezikonte kërkesat e kreditorëve të shoqërisë tjetër.

Prandaj bazuar në të sipër cekurat, gjykata konform nenit 23 të Ligjit për Falimentim (Ligji nr.05/L-083), dhe Nenit 387 pika h të LPK-së, duke vendosur që të konsolidojë zgjidhjen e këtyre çështjeve ligjore, duke pasur parasysh që ekzistojnë dy subjekte të ndërlidhura dhe me kërkesa të kreditorëve cilat mund të realizohen nga asetet e përbashkëta.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE

EF.nr.01/2019;08/2019, dt. _____

Gjyqtari

Këshillë Juridike: Ndaj këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta e ankesës.

Shtojca 3:

Aktvendim mbi pranimin e kërkesës, hapje të rastit dhe caktim të moratoriumit

EF.nr.01/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren....., duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar nga Debitori për inicim vullnetar të riorganizimit/likuidimit për hapjen e procedurës së falimentimit të Shoqërisë “ _____ ” me seli në _____, Rr., me Numër të Regjistrimit të Biznesit....., në prani të të autorizuarit të parashtruesit të kërkesës av. _____ nga _____ si dhe pronarit/aksionarit _____, në seancën e mbajtur me dt. _____, merr këtë :

AKTVENDIM

mbi hapjen e procedurës së falimentimit.

I. HAPET procedura e falimentimit ndaj shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ _____ ” sh.p.k me seli në _____.

II. Nga data e marrjes së këtij aktvendimi, mbi tërë pasurinë e Shoqërisë “ _____ ” Caktohet MORATORIUMI , dhe URDHËROHET NDALESA pa paralajmërim paraprak në lidhje me:

- 2.1 fillimin ose vazhdimin e çfarëdo veprimi gjyqësor, administrativ ose çfarëdo veprimi ose procedure tjetër të drejtuar kundër aktiviteteve afariste të debitorit ose pronave të tij duke përfshirë çfarëdo ngrirje apo bllokimi të llogarive bankare dhe veprimeve të cilat janë iniciuar ose do të mund të inicioheshin para hapjes apo inicimit të procedurës së falimentimit;
- 2.2 përmbarimin ndaj debitorit dhe pronave të tij të çfarëdo aktgjykimi të nxjerr para hapjes apo inicimit të rastit, përderisa përmbarimi i tillë është i ndërlidhur me aktivitetet afariste të debitorit;
- 2.3 çfarëdo veprimi me qëllim të marrjes në posedim ose me qëllim të ushtrimit të kontrollit ndaj pronave pjesë të pasurisë së falimentimit;
- 2.4 çfarëdo veprimi me qëllim të krijimit, regjistrimit ose përmbarimit të një barre ndaj pronave pjesë të pasurisë së falimentimit;
- 2.5 çfarëdo veprimi me qëllim të krijimit, regjistrimit ose përmbarimit të një barre, deri në masën që ajo barrë ndërlidhet me aktivitetet afariste të debitorit dhe deri në masën që ajo barrë siguron një kërkesë që ka lindur para inicimit të procedurës së falimentimit;
- 2.6 çfarëdo veprimi me qëllim të mbledhjes, vlerësimit ose rimarrjes së një kërkesë ndaj debitorit, deri në masën që veprimi ndërlidhet me aktivitetin afarist të debitorit dhe deri në masën që ajo kërkesë ka lindur para inicimit të procedurës së falimentimit; dhe
- 2.7 çfarëdo kërkesë për shlyerje të detyrimit drejtuar debitorit, të ndërlidhur me aktivitetin afarist të debitorit, kërkesë e paraqitur para inicimit të procedurës së falimentimit.

III. Autorizohet Administratori i caktuar me Aktvendimin EF.nr. _____, dt. _____, që të zhvillojë procedurën e falimentimit në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-083 PËR FALIMENTIMIN.

IV. Gjykata fton të gjitha palët që kanë kërkesa ndaj debitorit “_____” _____ me numër të biznesit _____, me pronar _____, me vendbanim në _____, në “_____” nr. _____, rrugën “_____” që të paraqesin kërkesat e tyre me shkrim pranë kësaj gjykate brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e pranimit së këtij aktvendimi.

IV. Me këtë aktvendim të njoftohet Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), Zyra e Pengut, Bankat Komer-
ciale në Kosovë, Regjistrin e kredive të Bankës Qendrore të Kosovës si dhe Administratën Tatimore të Kosovës.

Arsyetimi

Parashtruesi i kërkesës në cilësinë e _____, të “_____” Shoqërisë _____ me NRB _____, me seli në _____, ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, si pasojë e paaftësisë paguese të vërtetuar apo rrezikut të paaftësisë paguese në afarizmin e shoqërisë. Ka pretenduar se në bazë të analizës së biznesit të tij, në një periudhë të afërt kohore do të vij në situatë të pa-afësisë paguese respektivisht situata e pa-afësisë paguese veçse ka ndodhur pasi që shoqëria ka dështuar të paguajë detyrimet në afatet e përcaktuara.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 lidhur me nenin 18 dhe nenin 19 të ligjit për falimentim (ligji nr.05/L-083), gjeti se kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit është e bazuar, andaj edhe të njëjtën e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, sepse nga provat e prezantuara nga debitorit: _____, rezultojnë qartë se shoqëria tregtare në 6 muajt e fundit ka pasur bilanc negativ dhe vazhdimi i operimit do të rezultonte me paaftësinë paguese të tij, sepse eksitojnë detyrime mujore prej € _____, ndërsa në bazë të parashikimeve financiare, të hyrat e tij në periudhat vijuese do të vazhdojnë të bien nga të hyrat mujore - në muajin e fundit prej € _____, do të ketë zvogëlim të të hyrave nga € _____ për çdo muaj, ashtu që pas _____ muajsh të hyrat mujore të tij do të jenë € _____. Meqenëse i njëjti ka buxhet/rezerva në para të gatshme për mbulimin e humbjeve në shumë prej € _____, rezultojnë se ai nga të hyrat e biznesit dhe rezervat e tij do të mund të përmbushë detyrimet për pagesë vetëm për _____ muaj dhe pas kësaj periudhe do të ketë paaftësi paguese.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 26 të Ligjit për Falimentim, ku është përcaktuar se të gjitha kërkesat, procedurat që kanë për qëllim përmbushjen e kërkesave kundër debitorit do të ndërpriten.

Vendimi nga pika III e dispozitivit është marrë konform dispozitave të Nenit 7 dhe Nenit 25 par. 2, pika 2.3.

Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 46 dhe 49 paragrafi 4 të Ligjit për Falimentim, ku është përcaktuar se çdo provë e kërkesës do të paraqitet në gjykatë jo më vonë se 60 ditë, pas pranimit të njoftimit për hapjen e procedurës së falimentimit.

Vendimi nga pika III e dispozitivit është marrë konform dispozitave të Nenit 25 paragrafi 2 të Ligjit për Falimentim.

Bazuar në të të lartcekurat dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara gjykata ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike

III.EF.1/2019, me datë _____

Gjyqtarja

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate (neni 8.3 të Ligjit për Falimentim). Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e këtij aktvendimi (neni 8.5 i të njëjtit ligj).

Shtojcat 4:

4.1 NJOFTIMI i Gjykatës për Regjistrin e Biznesit, Regjistrin e Pengut, Administratën Tatimore dhe Bankat Komerciale për Hapjen

EF.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren....., duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar nga Debitori për inicim vullnetar për hapjen e procedurës së falimentimit dhe likuidimin e Shoqërisë “_____” me seli në _____, Rr., me NRB....., jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë _____, konform dispozitës së Nenit 25 par.2 pika 2.1, të Ligjit për Falimentim (ligji nr.05/L-083), merr këtë:

NJOFTIM

Për Hapjen e Procedurës së Falimentimit

Propozuesi /Debitori _____, me datë _____ ka parashtruar kërkesë për inicim vullnetar për hapjen e procedurës së falimentimit dhe likuidimin e Shoqërisë “_____” me seli në _____, Rr.,

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin III.EF.nr.01/2019, të datës _____ ka vendosur për fillimin e procedurës së falimentimit të Shoqërisë “_____” me seli në _____, Rr., me NRB.....

NJOFTOHEN Regjistri i Bizneseve, Regjistri i Pengut, Bankat Komerciale, Banka Qendrore, Regjistri i Kredive dhe Administrata Tatimore e Kosovës, për hapjen e rastit të falimentimit.

Pas pranimit të këtij NJOFTIMI të lëshuar nga gjykata, OBLIGOHEN Regjistri i Bizneseve, Regjistri i Pengut, Bankat Komerciale, Regjistri i Kredive dhe Administrata Tatimore që të shënojnë në regjistrat e tyre fillimin e procedurës së falimentimit të Shoqërisë “_____” me seli në _____, Rr., me NRB..... dhe të veprojnë konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit për Falimentim (Ligji nr.05/L-083).

Këtij Njoftimi i bashkëngjitet Aktvendimi mbi Hapjen e Procedurës së Falimentimit III.EF. _____, dt. _____.

Gjyqtarja

4.2 NJOFTIM Për shpalljen Publike të Hapjes së Procedurës së Falimentimit

EF.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren....., duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar nga Debitori për inicim vullnetar për hapjen e procedurës së falimentimit dhe likuidimin e Shoqërisë “ _____ ” me seli në _____, Rr., me NRB....., jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë _____, konform dispozitës së Nenit 25 par.2 pika 2.2, të Ligjit për falimentim (ligji nr.05/L-083), merr këtë:

NJOFTIM

Për shpalljen Publike të Hapjes së Procedurës së Falimentimit

Propozuesi /Debitori _____, me datë _____ ka parashtruar kërkesë për inicim vullnetar për hapjen e procedurës së falimentimit dhe likuidimin e Shoqërisë “ _____ ” me seli në _____, Rr.,

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin III.EF.nr.01/2019, të datës _____ ka vendosur për fillimin e procedurës së falimentimit të Shoqërisë “ _____ ” me seli në _____, Rr., me NRB.....

NJOFTOHEN të gjithë kreditorët e mundshëm që kërkesat e tyre ti parashtrojnë pranë Gjykatës brenda afatit prej 60 ditësh nga data e publikimit të shpalljes. Kërkesat e parashtruara me vonesë nuk do të merren për bazë.

Kreditorët kërkesat e tyre mund ti parashtrojnë në: Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, Pallati i Drejtësisë, Objekti A, Hajvali-Prishtinë

Njoftimi shpallet ne tabelën e shpalljes të Gjykatës dhe në më së paku në dy (2) gazeta ditore.

Gjyqtarja

Shtojca 5:

Aktvendimi mbi Emërimin e Administratorit

EF.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren....., duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar nga _____ për hapjen e procedurës së falimentimit dhe likuidimin e Shoqërisë “_____” me seli në _____, Rr., me NRB....., jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë _____, merr këtë:

AKTVENDIM

Mbi caktimin e administratorit të falimentimit

- I. CAKTOHET ADMINISTRATORI i falimentimit për administrimin e Shoqërisë “_____” me seli në _____, Rr., me NRB....., për administrator CAKTOHET z./znj. _____, administrator falimentues i licencuar nga Ministria e Drejtësisë.
- II. Administratori do të ketë të drejta të plota të merr menjëherë në posedim gjithë pasurinë e Shoqërisë “_____” me seli në _____, Rr., me NRB....., me pronar _____, si dhe i njëjti ka për detyrë që të ushtroj autorizimet e tij koform Ligjit për Falimentim dhe të veprojë në mënyrë profesionale, efikase dhe të paanshme.
- III. Obligohet pronari-aksionari i shoqërisë që ti respektojë në tërësi autorizimet e administratorit nën kërcënim të pasojave ligjore.
- IV. Shpërblimi dhe shpenzimet e administratorit do të caktohen me vendim të veçantë.

Arsyetimi

Parashtruesi i kërkesës në cilësinë e pronarit të Shoqërisë “_____” me seli në _____, Rr., me NRB....., ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit si dhe caktimin e administratorit falimentues.

Gjykata me datën _____, ka marr aktvendim lidhur me pranimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit pasi ka gjetur se kushtet specifike janë plotësuar andaj ka caktuar administratorin, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform dispozitave të Nenit 7 dhe Nenit 25 par. 2, pika 2.3. të Ligjit për Falimentim (Ligji nr.05/L-083) i cili përcakton se gjykata në procedurën e falimentimit të një debitori do të emëroj një përfaqësues të pasurisë falimentuese respektivisht administratorin, të cilit ky ligj i ka dhënë autorizime të posaçme në procesin e falimentimit sikurse janë cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi, si dhe detyrat tjera të përcaktuara me dispozita e Nenit 88 dhe 89 të Ligjit për Falimentim (Ligji nr.05/L-083).

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike
III.EF. _____ me datë _____

Gjyqtar

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Shtojca 6:

Aktvendimi mbi Shkarkimin e Administratorit dhe Emërimin e Administratorit të Ri

EF.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren....., duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar nga _____ për hapjen e procedurës së falimentimit dhe likuidimin e Shoqërisë “ _____ ” me seli në _____, Rr., me NRB....., jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë _____, merr këtë:

AKTVENDIM

Mbi shkarkimin e administratorit të falimentimit dhe emërimin e administratorit të ri.

- I. SHKARKOHET ADMINISTRATORI falimentues për administrimin e Shoqërisë “ _____ ” me seli në _____, Rr., me NRB....., i caktuar për administrator me Aktvendimin Ef.nr. ____ dt. _____.
- II. CAKTOHET ADMINISTRATORI falimentues për administrimin e Shoqërisë “ _____ ” me seli në _____, Rr., me NRB....., për administrator CAKTOHET z./znj. _____, administrator falimentues i licencuar nga Ministria e Drejtësisë.
- III. Administratori do të ketë të drejta të plota të merr menjëherë në posedim gjithë pasurinë e Shoqërisë “ _____ ” me seli në _____, Rr., me NRB....., me pronar _____, si dhe i njëjti ka për detyrë që të ushtroj autorizimet e tij koform Ligjit për Falimentim dhe të veprojë në mënyrë profesionale, efikase dhe të paanshme.
- IV. Obligohet pronari-aksionari i shoqërisë që ti respektojnë në tërësi autorizimet e administratorit të ri, nën kërcënim të pasojave ligjore.
- V. Shpërblimi dhe shpenzimet e administratorit do të caktohen me vendim të veçantë.

Arsyetimi

Parashtruesi i kërkesës në cilësinë e pronarit të Shoqërisë “_____” me seli në_____, Rr., me NRB....., ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit si dhe caktimin e administratorit falimentues.

Gjykata me datën _____, ka marr aktvendim lidhur me pranimin e kërkesës për hapjen e rastit të falimentimit pasi ka gjetur se janë plotësuar kushtet për fillimin e procedurës së falimentimit, andaj, me aktvendimin Ef.nr.____ dt.____. ka caktuar administratorin, z./znj. _____.

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesave së kreditorëve dhe vendimit nga mbledhja e veçantë e kreditorëve për shkarkimin e administratorit, ka gjetur se kërkesa për shkarkim është e justifikuar pasi administratori nuk i ka përmbushur detyrat e tij në mënyrë të plotë dhe profesionale në procedurën e falimentimit të Shoqërisë “_____” me seli në_____, Rr.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, Gjykata konform dispozitave të Nenit 87 lidhur me Nenin 7 dhe Nenin 25 par. 2, pika 2.3. të Ligjit për Falimentim (Ligji nr.05/L-083) merr vendim si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkarkimin e administratorit të falimentimit dhe emërimin e administratorit të ri, i cili do të ushtrojë të gjitha autorizimet dhe detyrat e tij në procedurën e falimentimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Falimentim (Ligji nr. 05/L-083).

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike
III.EF.1/2019 me datë _____

Gjyqtar

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

